Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Pranuar - Primljeno 11.11.2022
01-060/01-1285

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 të Ligjit Nr.03/L - 040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/15, Qershor 2008), dhe të nenit 42, paragrafi 42.3 të Statutit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, nenin 6, pika 1 e Rregullores për Punën e Kuvendit të Komunës së Vitisë, Nr.01-013/594, e datës 02.05.2014, kryesuesi i Kuvendit Komunal të Vitisë bënë këtë:

# F T E S Ë

Ftoheni të merrni pjesë në mbledhjen e **IX** të rregullt të Komitetit për Politikë dhe Financa, që do të mbahet me datë: **18.11.2022 (e Premte)** në ora 10:00.

Mbledhja do të mbahet në zyrën e konferencave të objektit të vjetër të Komunës së Vitisë.

Për këtë mbledhje kryesuesi propozon këtë:

## R e n d d i t e

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e tetë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
2. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim rregullores për ndryshim plotësimin e Rregullores me Nr.01-110/05-1057, të datës 29.09.2022 për taksa, ngarkesa dhe gjoba.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për aprovimin e Strategjisë për Zhvillimin Ekonomik Lokal 2022-2026.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për krijimin e kodeve të ri për projektet me perticipim.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shpalljen në konsultim publik të draft Rregullore për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim më pak se një vit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.**

**Viti, më 11.11.2022**

**Me respekt!**
**Kryesuesi i Kuvendit**
**Bekim Azizi**

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

# PROCESVERBAL
## NGA MBLEDHJA E TETË E KOMITETIT PËR POLITIK DHE FINANCA

Mbledhjen e thirri dhe e kryesoi z.Bekim Azizi, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë. Mbledhja është mbajtur më **21.10.2022 (e Premte )** në zyrën e konferencave të objektit e vjetër të Komunës së Vitisë, duke filluar me punë në ora 10 h. Në mbledhje morën pjesë: z.Hasan Aliu (nënkryetar i Komunës), z.Bekim Azizi (kryesues i Kuvendit Komunal), z.Ilir Zuka, z.Ramadan Deliu, znj.Zejnepe Osmani,z.Jakup Demiri, znj.Zyrafete Rama. Mungoj Liridona Bislimi. Morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive. Pasi u konstatua se prezent janë 6 anëtarë të KPF-së, andaj kishte kuorum, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

**Kryesuesi z.Bekim Azizi:** Përshëndetje për të gjithë ju anëtarë të KPF-së, nënkryetar, drejtoret që janë prezent në këtë mbledhje! Mirë se keni ardhur në mbledhjen e tetë të rregullt të KPF-së për këtë vit! Desha të ju njoftoj se shumicën e aktet që i kemi miratuar kanë marr ligjshmërinë nga ana e MAPL-së, përveç dy akteve që nuk ka është konfirmu ligjshmëria, te pjesa e obeliskut Albright është kërku dokumentacion shtesë, që është dergu nga Drejtoria e Urbanizmit dhe do ta presim informatën tjetër, ndërsa pjesa e diskutimit publik, te plani zhvillimor. Ai plan, domethënë është kthy vendimi që është marrë për diskutim publik, nuk është marrdh për diçka që është jo e ligjshme, po për shkak që nuk është përputh me formën që e kanë të ministrisë, që duhet me dalë aty vetëm për shkak përmbajtjes, formës, shabllonit, qysh duhet me shfaqë aty në është kthy edhe njëherë që duhet me ba plotësim në piken e fundit. A ka dikush jashtë rendit të ditës ju lutem?

**z.Ilir Zuka:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Ne e dimë që ka fillu viti shkollor edhe në Pozheran jeni të informumë krejtë se është duke u mbajtur mësimi prej orës 12:30 zyre mos me le me gabu deri në ora 20:00 ne e kemi pasë një kerkesë te drejtoria e inspeksionit apo te drejtoria e shërbimeve publike konkretishtë te Bushati për nja 10 herë e kam thirr në telefon dhe i kam bë kërkesë me i qit viat e këmbësorëve, për shkak që janë fshi dhe fëmija po kalojnë vend e pa vend. Kisha pas dëshirë me intervenu se është si urgjente. E kemi pas edhe një kërkesë prej policisë, po për fat të mirë ata ju kanë përgjigj pozitiv prej javës kalume është deri në ora 11 stacioni Pozheranit i hapur, kështu që tu i ditë vështirësitë që i ka shkolla e Pozheranit, të paktën këto mënyra me mujte me i ndihmu. Kam pas me fol edhe për kryetarin e Vetëvendosjes, për një prononcim që e ka bë në medja, po kam qef edhe unë me bë politikë pe lë në kuvend.

**z.Ramadan Deliu:** Përshëndetje për të gjithë! Unë e kam një pyetje për drejtorin , vendimi për varrezat në Kabashë që na është kthy prapë a keni bë kerkes me ndryshu se ai nuk është lumë me ndryshu emrin edhe me qu në kuvend me votu

**z.Ajet Sallahu:** Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Unë thirrjen e kam marrë shumë shpejtë. Kërkoj falje, sot nuk mundem me dhanë përgjigje, në seancën e ardhshme sigurisht ka me tu përgjigj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, për këtë mbledhje kemi këtë:

1. **Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e Komitetit për Politikë dhe Financa.**
2. **Pasqyrat Financiare të buxhetit komunal për periudhën Janar-Shtator 2022.**
3. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e Draft Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Kolegjit UBT dhe Komunës së Vitisë për hartimin e hartës zonale të Komunës se Viti.**
4. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër (1 deri 15 vite), të pronave të paluajtshme komunale përmes ankandit publik.**
5. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shqyrtim publik projekt Planin e Zhvillimor Komunal të komunës së Vitisë 2022-2030.**
6. **Informatë e prokurimeve dhe kontratave të nënshkruara për nëntëmujorin Janar-Shtator 2022**

**z.Ajet Sallahu:** Unë i kamë 3 çështje. E para, piken e katërt të rendit të ditës me terhek, sepse kjo kishte kaluar më herët në kuvend, edhe është formu komisioni. Kjo pikë të hiqet prej rendit të ditës. E dyta, i kam dy propozim ndryshime të vendimeve të mëparshme, që është propozim ndryshim për shpronësim kadastral, që i keni marrë me vendim të mëhershëm. Ministria na i ka dhanë disa sugjerime për me ndryshu, nëse ka mundësi ju lus juve dhe anëtarëve të komunitetit, për shkak të ndjeshmërisë, sepse është fjalën për parcelat që janë te Varret e Dëshmorve, është ish stacioni i veterinarisë edhe parku Sllatinë që janë pronë e AKP-së. Dje isha me zyrtarë atje, na dhanë sugjerime se cilat me shku procedurat dhe çka me ndryshu. Në propozim vendim e këna bë ndryshim plotësimin, kena me përmirësu edhe pak në mënyrë që me shku si pik e rendit të ditës. E kam edhe një pikë të rendit ditës që ka ardh si e ligjshëm prej ministrisë, mirëpo me sugjerimin e Agjensionit Kadastral për Regjistrimin e Pronës me ndryshu vendimin nga caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit të gjykatës në dhënien shfrytëzim afatgjatë të pronës për ndërtimin e objektit të gjykatës. Këto dy lutjet e mia ishin me hi si pika të rendit ditës për seancën e ardhshme.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi**: Te pjesa e ligjshmërisë kjo na ka ardh masi e kemi kry seancën KPF-së. Te këto zonat që i kemi shpallë në interes, kjo ka qenë që e kemi shpallë me interes edhe më herët mirëpo aty shkrun plotësim ndryshim i ligjit dhe ai plotësim ndryshim na i ka leju këtë formë që e kemi dhanë. Tashti edhe ka kërku që nuk janë në harmoni me ligjin, po na ka ardh me vonesë dhe domethënë tash duhet të shfuqizohet apo vetëm plotësim ndryshim. Kjo te gjykata komunale, ne e kemi bë vendimin për ndarjen e lokacionit në seancën e Janarit nëse nuk gaboj, ndërsa ato e di që edhe këta të gjykatës më kanë thirr, e dijë që kanë bë edhe kërkesë kemi bisedu që atyre ju ka kërku dokumenti për dhënie në shfrytëzim. Kjo është në procedurë të plotë. Unë prej pikave të rendit ditës që më kanë ardh, parimisht do të duhet t'i diskutoj. Unë mendoj që kjo të hiqet gjithqysh, se kjo veç është e miratume dhe kjo në seancën e Qershorit është miratu, është edhe komisioni që e kemi bë, që do t'i kryej me procedurë të ankandit publik të njëjtën kohë është bë edhe një parcelë tjetër në Smirë, diku nja 18 ari edhe për atë e kemi bë komisionin. Tjetra që tha edhe Iliri, na ka ardh pa protokolu, parimisht ki vërejtje Fatlum, pikat që vinë prej rendit të ditës, zakonisht unë i kam besu pikave që na kanë ardh. Unë parimisht këtu nuk shkrun se cilat parcela dhe e kemi pranu si pikë në momentin që na ka ardhë materiali unë e kam ditë që kjo si pikë është e kryme më herët. Domethënë pikat pa procedu, pa protokoll nuk vinë nëpër takime, duhet me pas kujdes në seancat e tjera ma bjen materialin, ma bjen kërkesën dhe fillojmë mbledhjen. Po unë mendoj që ne kemi edhe pika tjera që duhet t'i diskutojmë nënkryetar, e kemi piken që na ka ardh te kjo marrëveshja me UBT-në. Ne një marrëveshje me UBT-në në seancën e qershorit nëse nuk gaboj e kemi miratu dhe në kuadër të këtij miratimi të marrëveshjes, neve na ka ardh prapë e njëjta, që unë mendoj që kjo nuk është në rregull nënkryetar, ne kur e kemi miratu marrëveshjen domethënë është materiali i njëjtë, përpos kësaj është materiali që është i nenshkrum. Marrëveshja që e kemi qu në ministri, tash ne një marrëveshje të nënshkrume, domethënë e kemi miratu, edhe ministria na e ka kthy në komfrom ligjit që është kry kjo, domethënë kjo është e përfundume, tash na ka ardh një marrëveshje tjetër e pa nënshkrume, e pa protokolume po është e njëjta dhe kjo tash ne një marrëveshje kur e kemi miratu të nënshkrume kur është e nënshkrume

ditës.

**Nënkryetari, z.Hasan Aliu:** Faleminderit kryesues! Plotësisht edhe unë kam pas mendimin si tëndin, megjithatë pas aprovimit nga ana e kuvendit komunal dhe marrjes ligjshmërisë, ka pas ankues në adresë të UBT-sæ dhe kanë shku te Agjensioni Antikorrupsion dhe prandaj ata më kanë sugjeru në atë kohë. Ti e ke kalu si draft marrëveshje në kuvend dhe pas miratimit si draft marrëveshje duhesh edhe njëherë me kalu si marrëveshje përkundër krejt atyre fjalive që unë i kam thanë, por megjithatë me një fjalë mos u murrët shumë me këtë problematikë, jam tu ja bë qefin, se draft marrëveshja kur i nënshtrohet kuvendi dhe miratohet, marrëveshja behet marrëveshje, por në këtë formë e ka kerku agjencia antikorrupsion. Jam marr nja 3-4 ditë me ta dhe tash pikërisht për atë ja kam sjell këtu. Besoj që të keqe te kundërligjshme nuk ka, por ka përsëritje të procedurës dy herë për shkak se me siguri që këta badihavgji rrugëve, po kanë kohë me bë kësi lloj ankesa. Tani 1 javë ditë merresh ti me ta, qishit dokumenti kërkojnë dhe arsye është kjo se, e kemi pas edhe ne në konsideratë, edhe un edhe Fatlumi e kam ngrit edhe në aspekt procedural, se draft marrëveshja, momentin e aprovimit behet marrëveshje.

**z.Ilir Zuka:** A munden me na qitë ndonjë problem Ministria e Pushtetit dhe Administrimit Lokal kur e qon atje, se përshembull ti e ke kalu këtë, çdo pikë që na vjen na vjen si propozim vendim e kur kthehet bëhet vendim.

**Nënkryetari, z.Hasan Aliu:** Unë e kam sjellë, se ministria e ka konfirmu, ti e ke kalu këtë, prandaj s'ka nevojë edhe atë dokument unë e ruaj. A e kemi të kjart, unë po du me pas mbulueshmëri në radhë të parë për kabinetin e kryetarit edhe për kuvendin.

**z.Bekim Azizi, kryesues i kuvendit:** Pika e katër e rendit të ditës tërhiqet nga rendi i ditës në kuadër të propozimeve të drejtorit. Unë po e qes në votim që këto dy pika të hinë në rend të ditës. Nga të gjithë u miratuan, që dy pikat e propozuara të hyn në rend dite. E qes në votim për miratim rendin e ditës. Nga të gjitha u miratu rendit i ditës.

Si pikë të parë të rendit të ditës kemi:

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e shtatë e Komitetit për Politikë dhe Financa**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi qe nuk ka për diskutim, e qes në votim për miratim. Nga të gjithë u miratu procesverbali.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi:

**2. Pasqyrat financiare të buxhetit komunal për periudhën Janar - Shtator 2022**

**z.Berat Zuka, zyrtar i Drejtorisë për Financa:** Përshëndetje për të gjithë! Në mungesë të drejtorit i cili është në udhëtim zyrtar jashtë vendit, bazuar në Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave, neni 45, organizatat buxhetore i obligon që, brenda periudhës tre mujore të përgatitin raportet financiare të dërgojnë në kuvendin komunal dhe ti publikoj ne web. Sektori jonë, edhe pse ka qenë i angazhuar me buxhet pas miratimin në kuvend, mirëpo i kemi përgatit pasqyrat financiare, me datën 14 Tetor i kemi dërguar, ndoshta po i vonojmë pak, sepse Fatlumi gjithherë naj kërkon me kohë po kemi edhe të hyra të tjera e sun po i bëjmë me kohë. Te këto pasqyra i kemi të paraqitura të hyrat dhe të dalat ose alokimet e buxhetit dhe shpenzimet. E kam me veti edhe një listë sqaruese për disa kode, sepse edhe më herët i kemi sjell, kështu që me e sqaru më mirë. Materialin e keni marr me kohë, për pyetjet shtesë jam në dispozicionin e juaj.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Hapi debat për këtë pike të rendit të ditës.

**z.Jakup Demiri:** Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pasqyrat financiare, shohim se të hyrat dikun janë të realizueshme 85.13%, ndërsa krahasuar me të hyrat e një viti më par, të hyrat janë dikun për 24 mijë 775 euro më shumë. Po filloj me shpenzimet e përgjithshme të pasqyrat vjetore, Berati i shpjegoj, po po e jap si vërejtje, që është mirë kur të vjen materiali me na ardh edhe qekjo listë, pavarësisht që e keni shtu me një kod të jen më të sqaruara më mirë, duhet me naj sjell së bashku me material. Tek shpenzimet e rrymës i kemi 132

euro që dikun janë për 1550 euro me të ulëta se vitin e kaluar e që mendoj që këto shpenzimet mund të minimizohen edhe shumë më shumë, sepse telefoni mobile me hargju 12 mijë euro për 9 muaj nuk është hiq e arsyeshme. Mobile e kemi prapë kodin 13501, ku është 41 mijë e 979 euro, janë mobil, nuk e dimë se çfarë mobile janë këto. Pajisje të tjera, kodi 13509, janë 118 mijë e 993 euro. Çka janë këto, çfarë pajisje, furnizim me ushqim dhe pije, jo dreka zyrtare i ke 11 mije e 351 euro, furnizim me veshmbathje 4410 euro. Çka janë këto? Derivate të veturave i kemi 42 mijë e 66 euro; mirëmbajtja dhe riparimi i automjeteve 20 mijë, nuk është shumë; dreka zyrtare janë 26 mijë e 458 euro. Cilat janë këto dreka? Te shpenzimet e telefonisë, krahasu vitin e kluar me këtë vit, këtë vit janë 1553 euro me te vogla. Unë mendoj që janë shumë, sepse ka mundësi mu shfrytezu rrjetet sociale, derivate për vetuara i kemi krahasimi këtë vit me vitin e kaluar i kemi për 18 mijë e 973 euro me shumë. A është si pasoj e çmimit të ngritur apo jemi tu hargju më shumë në litra. Tek mirëmbajtja e autorrugëve: a është shtu metri katror apo është rrit çmimi.

**z.Berat Zuka, zyrtar i Drejtorisë për Financa:** Si raport financiar po e ngarkojmë me shënime të tepërta. Më herët kem pas edhe vërejtje, pikërisht nga Komiteti për Politikë dhe Financa, se një raport tjerat komuna me 7-8 faqe e prezanton, mirëpo ne jemi tu shku në kuadër të pasqyrave financiare edhe për juve me u kanë më të kapshme më të lehta. Edhe neve na duhet si kontroll e buxhetit me u kontrollu shpenzimet me sistemin e balancës, me arkivën tonë, kurse kjo e pasqyrave sqaruese mundemi me paraqit si ta parasheh të arsyeshme. Për shpenzimet aktuale, unë si zyrtar i drejtorisë nuk mundem me dhanë shënime të sakta ose juve me ju bind pse ka ndodh, po këto janë shpenzime që kanë ndodhë për shkaqe të ndryshme. Përshembull te ne e dimë sa i kemi marrë më herët, sa paguajmë. Tash është një çmim i ngritur, kurse te këto tjerat që Jakupi i kërkoj te mobiljet, kemi 3 parë furnizime, kemi furnizimi me invertare nëpër shkolla 29 989 euro, invertar për ambulanta 10 mijë euro, furnizim me invertar edhe drejtoria e inspeksionit 1490 euro, një shumë totale në raportin e juve është gati 42 mijë euro. Te pajisjet tjera, kemi furnizime për të gjitha pagesa për projektin; mirëmbajtja e ndriçimit publik dhe deponimit të qytetit. Shuma prej 47 mijë euro, ventilimi qendror në objektin e ri të komunës 3994 euro, furnizimi me projektor nëpër shkolla 35,980 euro. Domethënë është një kod i pajisjeve që të gjitha duhet të evidentohen, mirëpo kodohen shpenzime te ndryshme nëpër programe të ndryshme, si shihen furnizime, pastrimi, mandej derivatet e veturave.

**Nënkryetari, z.Hasan Aliu:** Këto të cilat janë kode të përgjithshme, shërbimet kontraktuese, pajisje tjera. Këto i merr, i specifikon sikur po i thu këtu dhe në kuvend I sjell shefit të grupit Vetëvendosje, PD-së, LDK-së tashti, por mos me u zgjenu debati shumë, kanë të kjart se çka ka ndodhë aty.

**z.Ramadan Deliu:** Mu po më quditni që po thu e ban një shefit të grupit. Pse nuk ja jepni Fatlumit edhe i shkep nëpër krejt.

**z.Ilir Zuka:** Unë po quditna kush e ka marrë këtë vendim. Për këtë thashë edhe nuk po foli. Shefi i grupit po na përfaqsojka neve, ne nuk paskemi nevojë me qenë hiq. Është e pahijshme kryesues, nëse kërkojmë do ta kërkojmë për krejt, se shefi i grupit e përfaqëson vetëm veten, nuk mundet me na përfaqësua neve.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** A jeni që kjo pikë e rendit të ditës të shkon në kuvend. Nga të gjithë u miratu.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

**3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për miratimin e Draft Marrëveshjes për Bashkëpunim ndërmjet Kolegjit UBT dhe Komunës së Vitisë për hartimin e hartës zonale të Komunës së Vitisë**

**Nënkryetari, z.Hasan Aliu:** Faleminderit kryesues! Nëse e kemi pas edhe më herët një draft marrëveshje, është pa ndryshime. Unë fillimisht ju tregova cila ka qenë arsyeshmëria, që për mua është e palogjikshme, po megjithatë me i ikë thirrjeve dhe kontrollave të cilat bëhen, duhet me u pajis me dokumente të cilat janë edhe për agjensi edhe për ministri, por edhe për komunë. Arsyeja është kjo të cilën e kam sjell, e kam konsideru që në këtë seancë edhe diskutimi publik me u përputh, se ata veç i kemi qit dhe jemi detyru me terhek që të shkon në këtë seancë, që të fillohet për shkak të interesimit të madh të kompanive të ndryshme për ndërtim

është ajo. Të gjithë jeni dëshmitarët të asaj, që draft marrëveshjen e posaqme e keni pas, është pa ndryshime.

**z.Jakup Demiri:** Unë deshta me dhanë një vërejtje, kjo ka qenë seancë e muajit maj. Na ka ardh pak von, shqetësimi është që ne nuk kemi pas kohë as me analizu materialin dhe e kemi votu një dokument të paanalizum. Tasht nuk po hi anej te puna e ministrisë, dokumentin plotësues na nuk kemi pas kohë me lexu, e dini mirë kolegët që e kemi votu kur është një dokument kaq i rëndësishëm, mendoj që duhet të kemi kohë kogja shumë që të marrim edhe opinionin prej profesionisteve, se e kemi votu një dokument siç është plani zhvillimor komunal.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Unë nuk mundem me u bind që kjo duhet me ardh apet në kunvend, se kemi votu një herë, mirëpo herën e parë ka ardh si drafte, tashti si marrëveshje.

**Nënkryetari, z.Hasan Aliu:** Ne e kemi formu një grup në kuadër të komunës. Kjo grupa punuese ka nevojë për ekspert, këta e kanë kry një pjesë bukur të madhe, është një ekip prej 15 vetave dhe që tash kjo marrëveshje është. Gjitha punët çka ju preket punëve administrative në komunë, grupa punuese e jona bashkëpunon, ne kemi me I hap rrugë një ekipi që është ma profesionist për këtë çështje. Tani hartimi I hartave zonale, ato do të dalin edhe në diskutim publik, do të vinë në kuvend, a I kanë bë mirë a si kanë bë 7 ditshmi I parë të cilin e kemi pas në diskutim publik, a besoni asnjë njëri nuk ka shku në shqyrtim publik dhe është shumë brengosëse se kur i ki vërejtje ulen njerëzit profesional të asaj lamie edhe cilat kanë mundësi të inkorporohen do të inkorporohen edhe do ta kemi ndikimin e qytetarëve në vendimmarrje.

**z.Jakup Demiri:** Komuna ka emru stafin për grupin punues bazë të projektin e hartës zonale komunale për Komunën e Vitisë, asnjë nuk e ke.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** A jeni që kjo pikë e rendit të ditës të shkon në kuvend? Nga të gjithë u miratu.

Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi:

**4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shqyrtim publik projekt Planin e Zhvillimor Komunal të komunës së Vitisë 2022-2030**

**z.Visar Demiri drejtor:** Përshëndetje për të gjithë! Ne veç në muajin e kalum e kemi pas në kuvend këtë pikë, po për shkak të një shablloni që se kemi ndjek gjatë hartimit të propozim vendimit, ministria na e ka kthy përmbajtësish. Pak a shumë është e njëjta, s'ka ndryshu ku me ditë çka me këtë Plan Zhvillimor Komunal të vitit 2022-2030, i cili do të ekspozohet në sallën e kuvendit të komunës, në shtëpinë e kulturës për të promovu gjithëpërfshirjen e transparencën do të mbahen edhe prezantime shtesë sipas planit të organizimit të aktiviteteve gjatë kohës së shqyrtimit publik për të gjitha prezantimet publike do të mbahet procesverbal. Shqyrtimi i Projektit Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së Vitisë 2022-2030 zgjatë 30 ditë sipas procedurave të përcaktuara me ligje. Ky propozim vendim shfuqizon vendimin për shpalljen shqyrtim publik të Projekt Planit Zhvillimor Komunal të Komunës se Vitisë me Numër 01-110/05-1061, i datës 29.09.2022.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** A jeni që kjo pikë e rendit të ditës të shkon në kuvend? Nga të gjithë prezent u miratu edhe kjo pikë.

Si pikë e pese e rendit të ditës kemi:

**5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e Propozim Vendimit për ndryshim plotësimin e Vendimit Nr.01-110/05-1067, të datës 28.09.2022 për shpalljen interes të përgjithshëm ngastrën kadastrale në Zonën Kadastrale në Viti, Radivojc dhe Sllatinë**

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Ne veç e kemi shpallë zonë me interes. Tashti parimisht bëhet plotësim ndryshimi i ligjit për shpronësim. Më herët veç i kemi shpallë çdo 3-4 vite, i kemi ruajt këto zona që i përmendi drejtori, varrezat e dëshmorëve dhe tashti propozimi që ka ardh te drejtori të hyn në rend të ditës që të bëhet ky plotësim, që të shpronësohen këto prona, të jen prona komunale në të ardhmen.

**z.Ajet Sallahu:** Propozimi është bë krejt në rregull, nuk ka asgjë në kundërshtim me ligjin, mirëpo tashti i shtohet edhe preambulla ligji mbi shpronësimin, se kjo është një shpronësim i AKP-së, prandaj këtu shkohet

Planifikimit dhe infrastrukturës, që të filloj procedurat e shpronësimit. Domethënë ne e përgatisim elaboratin, ja bëjmë kërkesën ministrisë dhe ministria përgatit shpronësimin.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** A jeni që kjo pikë e rendit të ditës të shkon në kuvend? Nga të gjithë u miratu.

Si pikë të gjashtë të rendit te ditës kemi:

6. **Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndryshim plotësimin e vendimit Nr.01-110/05-110, të datës 01.02.2022, për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Gjilan dega në Viti**

**z.Ajet Sallahu:** Pas ndërhyrjes së agjensionit kadastral, se kjo pronë me këtë vendim që e keni marrë është kanë në rregull, jo i paligjshëm, mirëpo agjensioni kadastral ka ndërhy se nuk duhet të bëhet caktim i lokacionit për ndërtim të objektit, po për dhënie në shfrytëzim në raste të veçanta të pronës komunale dhe të jepet në shfrytëzim dhe që në fund edhe kryetari i komunës të nënshkrun marrëveshje, në këtë rast me Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Në bazë të saj, ndërtimet që i banë komuna, investimi i komunës që bëhet edhe i qytetarit, domethënë kjo është caktim lokacionit, objekti që ja jep gjykatës, ai është objekt në shfrytëzim. A jeni që kjo pikë e rendit të ditës të shkon në kuvend. Nga të gjithë u miratu.

Si pikë të shtatë të rendit të ditës kemi:

**7. Informatë e prokurimeve dhe kontratave të nënshkruara për nëntëmujorin Janar-Shtator 2022**

**z.Fadil Abazi:** Unë e kam prezantu një informatë prokurimeve gjatë nëntëmujorshit të vitit 2022. Ju e keni tabelën ku cilën përshkruhen të gjitha projektet që janë me shuma operatorin ekonomik, data e lidhjes, kontratën dhe të gjitha tjerat. Deri tash i kemi përmbyll 46 aktivitete, ndërsa krejt procedura I ka 62, tjerat 16 janë në procedurë e sipër. Në kryerjen e procedurave, kemi 2 raste me procedura të hapura, me 18 raste është kuotim I çmimeve me I rast është procedurë minimale dhe me I aktivitet kemi miniprocedurën, ndërsa sa I përket ndarjes sipas punëve dhe shërbimeve, I kemi 18 aktivitete që janë shërbime, 14 aktivitete janë punë, 30 janë furnizime, shuma tjera nuk e di, tekstin e keni a me lexu krejt apo mundemi me vazhdu me tabelën.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Nëse kish bë një skjarim me kuptu, te kjo rubrika e dytë ku është vlera e parashikuar e kontratës pa u bë zotimi edhe rubrika e 3, çmimi i kontratës duke i përfshi të gjitha taksat, përshembull projekti 2 vjeçar shërbime me Karitas, kontrata e nënshkrume 700 mijë. Tashti kemi disa vende të njëjta, kemi riparim nëpër shkolla, vlera e zotume 360 mijë, kontrata 213, po kemi edhe raste kur është vlera e zotume ose e planifikume me e madhe, pjesa më e vogël. Tashti këtu një skjarim profesional.

**z.Fadil Abazi:** Paraja rrjedh, nuk mundesh krejt zotimin e ka kuptimin që ato pare komuna i ka planifiku. Ky 700 mij nuk është për I vjet, po për 2. Të gjitha rastet që I shifni ku janë vlera e planifikur dhe vlera e kontratës, e njëjtë janë kontrata kornizë me çmimin njësi, aty është tavani, tashti e lidh një kontratë, e jep një njësi 132 euro ose me 4 mijë euro, ndërsa shumën e kontratës e ka 700. Ai është tavani, kemi raste ku ka njëherë I kemi kalu planifikimet për shkak te rrethanave të tilla të tregut që janë përshebull te shkollat. Mirë është 316 213 oferta, kjo është pak herët në Pranverë, ndërsa kemi rritje dikun te punët ka pak I kemi kalu, mirëpo problem është krejt te tregu I çmimeve, sivjet nuk ka pas një standard, përshembull nëse vjet e kemi kontraktu asfaltin që e bëjmë zakonisht me 7 cm, çmimet janë kontraktu prej 5.5 deri 6, sivjet është prej 12 e përpjet. Ligji e lyp vetëm me u zotu, me u plotësu autoriteti në këtë rast financat me u zotu, se prej te hyrave të tashme muj me inkorporu këtu, domethënë janë kode ekonomike të hapura që ka mundësi me qitë, në ta ki të hyrat 200 mi euro I merr I shperndan të gjitha ka pak. Kemi pas raste të tilla edhe viteve të tjera, që I kemi tejkalu kaniherë, mirëpo gjithmonë I kemi mbyll, gjithmonë në vit të ri dalmi mirë, nuk kemi mbet borxhe kurrë, se problem është nëse ti e ngarkon buxhetin edhe del I milion apo 2 milion borxhe. Ne kurrë s'kemi borxhe, një provojë e mirë, një traditë e mirë që me I krahasu veç Gjilanin edhe Ferizajn I shef gjithmonë I bartin edhe kur të ndërrohen pushtetet, ka 5-6 milion I kanë borxhe, sepse lidhin kontrata të paarsyeshme. Ne gjithmonë këto I diskutojmë, I aprovojmë, a kemi mundësi me këtë kapacitet, me këtë vlerë me përmbyll, me

nuk është zhvillu, hiq puna dhe janë bartë këto bartje vinë përmes kuvendit nëpër kode buxhetore.

**z.Ramadan Deliu:** Deshta me vet, furnizimin me gjenerator te komuna e re, 23 mijë euro. Aty është gjeneratori, nuk e kanë kall kurrë.

**z.Fadil Abazi:** Kemi provu 2 herë me ndreq, nuk bënë, edhe zyra ka bë kërkesë një gjenerator me ble 16 mijë e 100 euro.

**Kryesuesi, z.Bekim Azizi:** Kjo pikë e rendit të ditës nuk shkon në kuvend. Ju falënderoj për kontributin e dhënë në këtë mbledhje. Me kaq e përfundojmë këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

| | |
|---|---|
| **Procesmbajtësi:** | **Kryesuesi i Kuvendit Komunal:** |
| **Fatlum Demiri** | **Bekim Azizi** |
| ______________ | ____________________ |

Pranuar - Primljeno - Received 10-11-2022
Nr. i organit / Org. broj | Numri / Broj | Shifra | Vlera
02-035/02-1276

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

**PROPOZIM RREGULLORE**
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E RREGULLORES**
**PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA, ME NR. 01-110/05-1057, E DATËS.29.09.2022**

VITI, Nëntor 2022

Në bazë të nenit 58 paragrafi 1, pika h të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nenit 2 paragrafi 1 dhe 2 lidhur me nenin 9 dhe 13 të ligjit nr.03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, kërkesën me Nr. 43-870/5 e datës 24.10.2022 nga MAPL-ja si dhe nenit 50 paragrafi 1 pika 1 të Statutit të Komunës së Vitisë nr. 01-013/491 të datës 21.04.2011, Kryetari i Komunës paraqet këtë:

# PROPOZIM RREGULLORE
## PËR NDRYSHIMIN-PLOTESIMIN E RREGULLORES
## PËR TAKSA, NGARKESA DHE GJOBA ME NR. 01-110/05-1057, E DATËS.29.09.2022

**Neni 1**

Kjo Propozim rregullore ka për qellim ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba komunale me Nr. 01-110/05-1057, e datës:29.09.2022.

**Neni 2**

Te rregulloja baze neni 11 pika 11.3 pika c) ndryshohet dhe plotësohet si në vijim dhe duhet të jetë:
**Dru teknik për m$^3$ në shumë prej 3.00€**

**Neni 3**

Te rregullorja baze neni 12 paragrafi 12.1.8, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim dhe duhet të jetë:
**Qiradhënie e banesa jepet duke u bazuar ne Ligji Nr. 03/L – 164 për financimin e programeve të veçata të banimit, komuna gjate dhënies me qira të këtyre banesave duhet ti këtë prioritet personave që kane më shume nevojë për banim, ndërsa objektet që janë në pronësi të komunës ipen përmes ankandit publik dhe legjislacionit në fuqi.**

**Neni 4**

Te rregullorja bazë, neni 28 paragrafi 28.1 i rregullores baze pas fjalës "adminsitrative "i shtohet fjala "**kategorisë së dytë**", ndërsa pjesa tjeter e tekstit bazë të nenit përkatës mbetet e pa ndryshuar.

**Neni 5**

Te rregullorja bazë, neni 23, pjesa e katerët, ndryshohet dhe plotësohet si në vijim dhe duhet të jetë:
**Mospërfillja e pagesës se taksave se paku pas dy vërejtjeve do të rezultojë me inicimin e procedurës kundërvajtëse pran Gjykatës Themelore ne Gjilan Dega ne Viti në përputhje me nenin 29 të ligjit për kundërvajtjeje Nr. 05/L-087**

**Neni 6**

Te rregullorja bazë, nenit 41, i shtohet pika 41.5 me këtë përmbajtje:
**Procedurën për sanksioninim e kundërvajtësve me gjobe duke përfshirë nenet bazë të rregullores nga neni 38.39,40 dhe 41, ndëshkimet kundëvajtës behën nga drejtoria për Inspeksion.**

**Neni 7**

Pjesët tjera të rregullores bazë mbesin të pandryshuara.

**Neni 8**

Kjo propozim rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi Komunal i Vitisë dhe certifikimi ligjor nga MAPL dhe MEF.

Propozues: Kryetari i Komunës së Vitisë
Sokol Haliti

REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E VITISË OPŠTINA VITINA KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE

15-870/5
24 10 2022

# Republika e Kosovës
## Republika Kosova-Republic of Kosovo
### Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për: | **Sokol Haliti**, Kryetar i Komunës së Vitisë<br>**Bekim Azizi**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë | |
| Kopje: | Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komune<br>**Servet Spahiu**, Zv. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Mjedisit, planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës<br>**Blerim Hasani**, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural<br>**Lulzim Beqiri**,Zv. Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë | |
| Përmes: | **Elbert Krasniqi**, Minister i MAPL-së<br>**Venera Çerkini**, Zv. Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | **Besim Myrtezani**,Zv. Udhëheqës i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave | Datë: 17.10.2022<br>VI-43-870/1 |
| Zyrtaret përgjegjës:<br>1.Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor | **Xhevat Tafa**, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave | |
| 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor | **Leonora Bajrami**, Zyrtare për monitorim të komunave | |
| Lënda: | Raporti i vlerësimit të ligjshmërisë se aktit të Komunës së Vitisë nga komisioni ndërministror | |
| Lloji i aktit: | Rregullore e Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së (QRK) Nr. 06/2021 për Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2021 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| | | |
|---|---|---|
| | | Udhezimin Nr.12/2019 për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës.<br><br>Mirëpo, Udhezimi Administrativ Nr.12/2019 për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës, e ka numrin: Nr.12/2019 e jo 12/1019 si është shënuar në hyrje të nenit 10 të rregullores.<br><br>**Fusha e Banimit**<br><br>**Neni 12**<br>Drejtoria per shërbime publike<br><br>Neni 12 paragrafi 12.1.7 i rregullores , e rregullon çështjen e furnizimit me uji te pijshëm per rastet sociale, familjet e dëshmorëve, invalidë, invalid te luftës, per persona me aftësi te kufizuar dhe veteran te luftës, ndërsa në paragrafin 12.1.8 të të njëjtit e rregullon fushën e qiradhënës se banesave, por nuk e specifikonfare Ligjin Nr. 03/L-164 për financimin e programeve të veçanta të banimit.<br>Ndërsa në paragrafin ku shprehimisht thuhet se *" Komuna mundë të vendosë që rasteve sociale ti jep me qira banesat me çmim te subvencionuar. Ne këtë rast kriteret duhet 'te vendosin' qe ti japin prioritet njerëzve qe kane më shume 'nevoje"*, konsiderojm që kjo çështje duhet te plotësohet dhe te saktësohet sipas Legjislacionit ne fuqi.<br><br>**Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural:**<br><br>Rregullorja për taksa ngarkesa dhe gjoba e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vitisë dhe e nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Vitisë, nenit 11 pika 11.3 pika c) ndryshohet dhe plotësohet si vijon: c) Dru teknik për $m^3$ në shumën prej 3.00€<br><br>**Arsyetim**<br><br>Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, taksat për shërbimet profesionale për prerje të pyjeve private i ka të përcaktua në nenin 6 të Udhëzimit Administrativ MA- |

| **Rregulloren 01-110/05-1057 për taksa, ngarkesa dhe gjoba** |
|---|
| I miratuar më datë: 28.09.2022 |
| I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 29.09.2022 |

Komisioni ndërministror, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson së akti i komunës **është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi**.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

| Nr. | Formulimi në aktin e komunës | Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim |
|---|---|---|
| 1. | **Rregulloren 01-110/05-1057 për taksa, ngarkesa dhe gjoba.** | Rregulloren 01-110/05-1057 për taksa, ngarkesa dhe gjoba, e miratuar nga Kuvendi i Komunës së Vitisë, është shqyrtuar nga ministritë përkatëse, e të cilat pas vlerësimit kanë konstatuar se Rregullorja është në kundërshtim më dispozitat e legjislacionit në fuqi si vijon:<br><br>**Ministia e Mjedisit, Planifikimit Hapsinor dhe Infrastruktures:**<br><br>**Fusha e ndërtimit**<br><br>Në nenin 28 paragrafi 28.1 të Rregullores *Nr.01-110/05-1057* per taksa, ngarkesa dhe gjoba, sjprehimisht thuhet: *"tarifa e taksës administrative për leje ndërtimore në Komunën e Vitisë është dy euro (2.00 euro ) për metër katror"*. Në këtë rast, nuk është precizuar për cilën kategori të lejes ndërtimore bëhet fjalë.<br>Andaj, të precizohet se e njëjta ka të bëjë me leje ndërtimore të kategorisë së II, si parashihet me dispozitat ligjore në fuqi.<br><br>**Fusha e Agjencionit kadastral**<br><br>Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, konstaton se Rregullorja Nr.01-110/05-1057 per taksa, ngarkesa dhe gjoba, miratuar nga KK Viti, është në përputhje me Udhëzimin Administrativ Nr. 09/2020 për tarifat e shërbimeve për regjistrimin e te drejtave te pronës se paluajtshme dhe |

| | | |
|---|---|---|
| | | NR.12/2005 për caktimin e çmimeve – taksave për shfrytëzimin e produkteve pyjore-drunore, jo drunore dhe shërbime profesionale teknike, të datës 16 maj 2005.<br><br>Ministria përgjegjëse për bujqësi, kërkon që taksat për shërbimet profesionale për prerje të pyjeve private të harmonizohet me legjislacionin përkatës në fuqi.<br><br>**Ministria e Drejtësisë**<br><br>Rregullorja në nenin 23, 38, 39, 40, 41 përmban dispozita ndëshkimore penale të cilat konsiderojmë se duhet të harmonizohen dhe të jenë në pajtim me legjislacionin përkatës për kundërvajtjet.<br><br>Me qëllim që kjo Rregullore të jetë në një linjë dhe në pajtim të plotë me Ligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtjet, propozojmë plotësimet, si në vijim:<br><br>1. Neni 23 i Rregullores (pjesa e katërt e tekstit), të riformulohet si në vijim: *"Mospërfillja e pagesës së taksave së paku pas dy vërejtjeve do të rezultojë me inicimin e procedurës kundërvajtëse pranë Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti."*<br><br>Kjo, për faktin se Gjykata Komunale në Viti më nuk ekziston si term dhe kategori ligjore në legjislacionin në fuqi dhe sipas Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat, neni 10 (paragrafi 3, nën-paragrafi 3.2), Vitia organizohet si degë e Gjykatës Themelore të Gjilanit.<br><br>Arsyeja e dytë është se ndalimi i përkohshëm i veprimtarisë mund të parashihet si sanksion kundërvajtës në kuptim të nenit 27 të Ligjit për Kundërvajtjet, por i njëjti mund të |

| | | |
|---|---|---|
| | | shqiptohet vetëm nëse kryesit të kundërvajtjes fillimisht iu është shqiptuar gjoba (shih: nenin 28, parag. 3 të Ligjit për Kundërvajtjet).<br><br>Gjithashtu, në këtë rast duhet pasur parasysh se neni 27 (paragrafi 2) i Ligjit për Kundërvajtjet, përcakton se: ''*Për kundërvajtjet e personit juridik mund të parashihet vetëm sanksioni kundërvajtës me gjobë.*''<br><br>Çështja tjetër te neni 23 i kësaj Rregullore janë gjobat të ndarë në dy grupe, ku përcaktohet:<br><br>- grupi i parë 100 – 150 euro;<br>- grupi i dytë 50 – 100 euro.<br><br>Propozojmë që të riformulohet kjo dispozitë të sanksionet kundërvajtëse me gjobë të përcaktohen brenda limiteve të nenit 29 (paragrafi 4 dhe 5) të Ligjit për Kundërvajtjet dhe të specifikohen saktë gjobat kur bëhet fjalë për personin fizik dhe personin përgjegjës të personit juridik, personin fizik që ushtron biznes individual apo personin juridik.<br><br>Gjithashtu, është nevojë kruciale të përcaktohet në Rregullore edhe ''*organi kundërvajtës*'', pra të përkufizohet saktë se kush do të zhvillojë procedurën kundërvajtëse dhe kush do të shqiptojë sanksionet kundërvajtëse me gjobë, p.sh., në bazë të praktikave kjo bëhet zakonisht nga Drejtoria e Inspektimeve, ku përcaktohet te pjesa e Përkufizimeve e Rregullores se e njëjta për qëllimin e zbatimit të Rregullores është organ kundërvajtës. |

| | | |
|---|---|---|
| | | Po ashtu, në disa pjesë në tekstin narrativ të Rregullores është përdor fjala *''kundra vajtje''*. Propozojmë, që e njëjta të zëvendësohet me fjalën adekuate *''kundërvajtje''*, me qëllim të hartimit dhe përafrimit në bazë të standardeve gjuhësore të legjislacionit primar dhe sekondar. |

Bazuar në të cekurat më lartë, Komisioni Ndërministror, kërkon nga Kuvendi i Komunës dhe Kryetari i Komunës së Prizrenit që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Bashkangjitur gjeni raportet e vlerësimit të Ministrive të Linjës (MMPHI, MBPZHR, MD).

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

| | | |
|---|---|---|
| Republika e Kosovës<br>Republika Kosova<br>Republic of Kosovo | KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA<br>07.11.2022<br>02-035/02-1255 | Komuna e Vitisë<br>Opstina Vitina<br>Municipality Viti/na |

Në bazë të nenit 58, shkronja h e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 50.1, shkronja l të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, kryetari i Komunës së Vitisë paraqet këtë:

# PROPOZIM VENDIM

## për aprovimin e Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2022-2026

**Neni 1**

Kryetari i komunës i propozon Kuvendit të Komunës së Vitisë, që të miratojë Strategjinë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2022-2026.

**Neni 2**

Pjese përbërëse e këtij propozim vendimi është Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2022-2026.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij propozim vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim – Sektori për Zhvillim Ekonomik, dhe drejtoritë tjera të Administratës së Komunës së Vitisë.

**Neni 4**

Ky propozim vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës së Vitisë.

Propozues:
KRYETARI I KOMUNËS
Sokol Haliti

REPUBLIKA E KOSOVËS · KOMUNA E VITISË · KRYETARI I KOMUNËS · REPUBLIKA KOSOVA · OPŠTINA VITINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republik of Kosovo

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipal of Vitina

# STRATEGJIA
## PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL 2022-2026

(draft)

Viti, 2022

# PËRMBAJTJE

Përmbajtje ........ 2
Lista e figurave, Lista e tabelave........ 3
Fjala kryetarit ........ 4
Hyrje ........ 5
Ekipi punues ........ 6
Metodologjia e punës ........ 7
Misioni dhe vizioni ........ 7
Profili i zonës ........ 9
Buxheti Komunal ........ 11

## Kapitulli I

Gjendja aktuale ........ 13
Sektori privat ........ 13
Bujqësia ........ 22
Arsimi ........ 28
Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale ........ 36
Ambienti dhe Shërbimet Publike ........ 40
Kulturë, Rini dhe Sport ........ 42
Administrata ........ 49
Plani i Mobilitetit ........ 50

## Kapitulli II

Sfidat e Zhvillimit ekonomik lokal ........ 52
Sfot analiza ........ 55

## Kapitulli III

Objektivat e Zhvillimit ekonomik lokal ........ 60
Zhvillimi i Qëndrueshëm Ekonomik ........ 60
Zhvillim i Qëndrueshëm Social ........ 62
Menaxhimi i Qëndrueshëm ........ 64
Administrimi, monitorimi dhe evaluimi i strategjisë ........ 65
Shtojca: Paraqitja tabelare e objektivave dhe aktiviteteve ........ 67

## Lista e figurave:

Fig.1. Pozita gjeografike e Komunës së Vitisë në hartën e Republikës së Kosovës ..................... 10

*Figura 2.* Harta e pikave turistike ne Komunën e Vitisë ............................................................ *19*

Figura 3. Përshtatshmëria e Tokës Bujqësore në Komunën e Vitisë ............................................ 26

## *Lista e tabelave:*

*Tabela 1. Krahasimi, klasifikimi i ndërmarrjeve të regjistruara në komunat tjera ..................... 10*

*Tabela 2. Renditja e Sektorëve Ekonomik sipas numrit të ndërmarrjeve të regjistruara (ARBK) ..................................................................................................................................... 11*

*Tabela 3. Klasifikimi i sektorëve ekonomik sipas përqindjes së ndërmarrjeve të regjistruara në Komunën e Vitisë krahasuar me Komunën e Istogut dhe Skenderajt ...................................... 12*

*Tabela 4. Renditja e vendbanimeve (urbane dhe rurale) sipas numrit të bizneseve të regjistruara (ARBK) .................................................................................................................... 12*

*Tabela 5. Veprimtaritë punuese, bizneset, punësimi dhe qarkullimi ......................................... 13*

*Tabela 6. Sipërfaqja bujqësore e planifikuar për mbjellje për vitin 2020 dhe kulturat bujqësore ..................................................................................................................................... 17*

*Tabela 7 Sipërfaqja dhe përqindja e tokës bujqësore sipas klasave të përshtatshmërisë – Bonitetit ..................................................................................................................................... 18*

*Tabela 8. Fondi Blegtoral në Komunën e Vitisë për vitet 2016-2020 .......................................... 21*

*Tab. 9 Shënime të shkollave për numrin e nxënësve, mësimdhënësve duke përfshirë edhe administratën, infrastruktura e tjera te cilat janë të cekura ne tabelë ......................................... 28*

*Tab. 10 Kujdesi primar shëndetësor është i organizuar në 10 institucione shëndetësore të mjekësisë familjare ................................................................................................................ 29*

*Tab. 11 Qendra Kryesore e Mjekësisë familjare në Viti, raporti dymbëdhjetë mujor .................. 31*

*Tab.12 Qendra për punë sociale dhe mbështetja financiare ...................................................... 32*

*Tab.13 Skema gjinore e asistencës sociale .............................................................................. 33*

*Tab. 14. Infrastruktura Publike e Komunës së Vitisë deri me 31.12.2022 ................................. 35*

*Tab.15. Aktiviteteve kulturore artistike në shfaqje artistike teatrale dhe filmike, përformancë e artistëve dhe individual dhe kolektiv ........................................................................................ 36*

*Tab. 16. Administrata, numri i punëtorëve, struktura kualifikuese, struktura etnike ................. 39*

*Tab. 17. Përvoja e punës e shërbyesve civil në administratë sipas drejtorive, 2021 .................. 39*

*Tab.18. Institucionet e administratës dhe kapacitetet hapësinore ............................................ 42*

# FJALA E KRYETARIT



Të nderuar qytetarë!

Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2022-2026 për Komunën e Vitisë, synim ka zhvillimin e komunës sonë për katër vitet e ardhshme në proceset e rëndësishme të zhvillimit dhe forcimit ekonomik, nëpërmjet përformancës administrative, ngritjes së urave të bashkëpunimit institucional të nivelit horizontal dhe vertikal, me Qeverinë e Kosovës, bashkëpunimin me partnerët evropian, fondet e BE-së, OJQ-të ndërkombëtare dhe vendore, shoqërinë civile, mërgatën dhe komunitetin.

Vend të rëndësishëm në zhvillimin e Komunës sonë zënë resurset humane dhe ekonomike, përfshirë këtu edhe pasuritë të shumta, siç janë: toka bujqësore, resurset ujore, pasuritë nëntokësore dhe turizmi.

Përmes këtij plani ne synojmë të krijojmë institucione të forta dhe shërbyese, infrastrukturë jetësore dhe mirëqenie qytetare për të gjithë, hapje e vendeve të reja të punës, me qëllim që vitiasit të kenë një jetë më të mirë ashtu siç edhe e meritojnë. Ndër të tjera synojmë të promovojmë dhe ruajmë vlerat tona kulturore, pasi që komuna jonë njihet për vlera të larta në këtë aspekt, kryesisht edhe në objekte dhe monumente kulturo-historike me rëndësi të veçantë, jo vetëm lokale, por edhe shtetërore, siç janë dy objektet e shkollave të para të gjuhës shqipe: njëra në Stubëll të Epërme dhe tjetra në Pozheran. E gjithashtu edhe objekte tjera me rëndësi të veçantë. Ndonëse komuna jonë cilësohet edhe si djep i shkollave të para shqipe, ne natyrisht se po bëjmë çmos që të krijojmë kushte sa më të mira për mësimdhënie dhe mësimnxënie, duke investuar në objektet shkollore, ngase duke investuar në objektet shkollore njëherë ne investojmë në një të ardhme të ndritur të brezave që vijnë, për ta dërguar Komunën e Vitisë së bashku përtej kufijve administrativ.

Besoj fuqishëm se, kjo strategji do të jetë pikë e fuqishme orientuese e institucionit tonë komunal për zhvillimin e gjithmbarshëm të Komunës së Vitisë.

Sokol Haliti, kryetari Komunës së Vitisë.

# HYRJE

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal e Komunës së Vitisë paraqet vizionin institucional të zhvillimit ekonomik lokal, misionin, gjendjen aktuale, sfidat me të cilat përballet ekonomia lokale, përparësitë dhe mangësitë, mundësitë dhe rreziqet. Në esencë në këtë dokument strategjik janë paraqit objektivat e zhvillimit ekonomik lokal të Komunës së Vitisë.

Ky dokument strategjik mbështetet në dokumentet ligjore si rrjedhojë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Planin strategjik afatmesëm dhe afatgjatë të Qeverisë së Kosovës, Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin mbi Menagjimin e Financave dhe Përgjegjësive, Statutin e Komunës, Kornizën Afatmesme Buxhetore, Draftplanin Zhvillimor Komunal 2021-2029 dhe ligjeve pozitive në fuqi, duke filluar nga Ligji për Investime Strategjike deri te Ligji për Partneritete Publiko Private. Po ashtu ju kemi referu edhe strategjive të mëhershme alternative si pasuese e zhvillimit strategjik komunal: Planit Zhvillimor 2010-2020, Plani i Integruar Komunal 2018-2021, Agjenda Zhvillimore 2004-2007 dhe Strategjia 2003-2006.

Dokumenti strategjik i zhvillimit ekonomik lokal të Komunës së Vitisë nxjerr atraktivitetin dhe potencialin që ka Komuna e Vitisë për zhvillim ekonomik lokal, e njohur me mundësi potenciale në zhvillimin e bujqësisë, turizmit, pasurive nëntokësore që ndikojnë në zhvillimin e industrisë. Dokumenti pasqyron Komunën e Vitisë si vend i mundësive për zhvillim ekonomik lokal, stabilitetit dhe dinjitetit shoqëror.

## Ekipi punues:

1. Nexhat Arapi (kryetar i komisionit)
2. Përparim Sadiku (anëtar)
3. Halil Musliu (anëtar)
4. Avdirrahman Haliti (anëtar)
5. Xhylsime Qamili (anëtare)
6. Zoja Tapalli (anëtar)
7. Arbnor Zuka (anëtar)
8. Mustafë Islami (anëtar)
9. Naser Avdiu (anëtar)
10. Hajrush Kurteshi (anëtar)
11. Emrush Azemi (anëtar)
12. Zjadin Ahmeti (anëtar)
13. Tefik Salihu (anëtar)
14. Burim Sadiku (anëtar)
15. Xhelal Musa (anëtar)
16. Xhemajl Hasani (anëtar)
17. Merxhan Sahiti (anëtar)

Ekipi punues ka mbajtur takime të vazhdueshme gjatë hartimit të Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2022-2026, si:

1. Takimi i parë i grupit punues: Në këtë takim u njoftuam me grupin punues në përbërje nga anëtarë të departamenteve komunale, shoqërisë civile dhe bizneseve. Në takim u njoftuam me procedurat e fillimit të bërjes së Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2022-2026 dhe marrjen e përgjegjësive të caktuara punuese në ekip.
2. Takimi i dytë u mbajt me Bordin e Drejtorëve të Komunës së Vitisë, ku prezent ishte edhe kryetari i komunës, që si qëllim kishte bashkërendimin e punëve për hartimin e strategjisë.
3. Takimi i tretë ishte me biznese komunale, që si qëllim kishte njoftimin për hartimin e strategjisë dhe mbi mundësitë e interferimit të bizneseve në hartimin e kësaj strategjie, kërkesat e tyre, sfidat, përparësitë dhe mangësitë në sektorin privat.

Komisioni ka mbajt takime javore me ekipin e punës dhe përditore me komisionin e ngjushtë të punës (është bërë analiza e gjendjes aktuale nëpër sektor institucional, janë nxjerr përfundime, janë identifikuar sfidat dhe mundësitë, janë definuar objektivat, prioritetet, si dhe janë përcaktuar hapat dhe aktivitetet për realizimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik Lokal 2022-2026.

## METODOLOGJIA E PUNËS

Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2022-2026 është një platformë e punës, që ka për qëllim zhvillimin ekonomik komunal, duke nxjerr gjendjen momentale në të gjitha organet komunale vendimmarrëse, që kanë synim dhe qëllim politikat e zhvillimit ekonomik komunal.

Për hartimin e kësaj strategjie janë ndjekur metodat e bashkëpunimit ndërinstitucional, mbledhjen dhe analizimin e të dhënave dhe paraqitjen e vizionit, synimeve, objektivave, që kanë qëllim zhvillimin ekonomik komunal.

Fazat e metodologjisë së përdorur për hartimin e kësaj strategjie janë:

- GJENDJA Aktuale: ofrimin e të dhënave nga organet komunale për komisionin, ato sasiore dhe cilësore (duke aktivizuar nga një zyrtar në çdo organ komunal, duke shikuar bazën ligjore dhe evidencën zyrtare të gjendjes); grumbullimin, përpunimin, sistemimin dhe pasqyrimin e gjendjes.
- Ekzaminimi Sektorial (analizimi i gjendjes nëpër sektorë, konsultimi, përgjigje, SFOT-analiza).
- Planifikimi Strategjik (Definimi i objektivave, përcaktimi i prioriteteve dhe i aktiviteteve, përcaktimi i mekanizmave dhe aktereve për realizimin e strategjisë).

## Misioni dhe Vizioni

Komuna e Vitisë ka mision përmirësimin e gjendjes aktuale përmes politikave të zhvillimit ekonomik lokal, përfshirjen dhe barazinë sociale, ta afirmoj identitetin e saj të bazuar në traditën dhe trashëgiminë kulturore.

Vizioni i Komunës së Vitisë është aktivizimi i të gjitha kapaciteteve dhe potencialeve të disponueshme në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik lokal.

Bazuar në konfiguracionin e terenit, pejsazhin e saj te bukur, resurset dhe pasuritë natyrore dhe traditën dhe trashëgiminë e saj kulturore. SZHEL-ja pretendon Vitinë ta shndërrojë në një lokalitet:

- Me zhvillim të ekuilibruar, që do të mundësoj integrimin ekonomik e social;
- Ambient të volitshëm dhe atraktiv, që lehtëson dhe favorizon aktivitetet ekonomike dhe nxitë investitorët potencial;
- Me kapacitete të ndërtuara, që mundësojnë dhe sigurojnë rritje ekonomike dhe aftësi të avancuara konkuruese, që gjenerojnë punësim dhe mundësojnë rritje të të ardhurave, që garantojnë qëndrueshmëri ekonomike dhe siguri sociale;
- Me sektorë të zhvilluar bujqësorë, i cili me produktivitetin dhe prodhimet e veta mund të përballoj konkurrencën në treg dhe si i tillë të siguroj të ardhura stabile dhe të gjeneroj punësim dhe do të shërbejë si suport i standardit jetësor për qytetarët që varen nga veprimtaria bujqësore, e të cilët nuk janë në gjendje që përmes aktivitetit të tyre të përcjellin reformat ekonomike;

- Me zona turistike të zhvilluara të bazuara në resurset natyrore dhe trashëgiminë kulturore, me kapacitete të shumëfishuar për akomodim;
- Me infrastrukturë komunale moderne, me hapësirë të menaxhuar në bazë të planifikimit urban dhe mjedis të përshtatshëm ekologjik, që do të mundësonte rritjen e kualitetit të jetës;
- Me administratë efikase dhe efektive në shërbim të qytetarëve dhe të ekonomisë së saj;
- Me ambient të shëndosh dhe atraktiv për jetesë, në të cilin të gjithë do të ndjehen mirë dhe të sigurt, ku të rinjtë do të mund të ndërtojnë të ardhmen e tyre.

# KOMUNA E VITISË
## (Profili i Zonës)
## Të dhënat gjeografike dhe demografike

Koha e saktë e themelimit të Komunës së Vitisë nuk mund të vërtetohet, por sipas disa të dhënave të shkruara dhe ato materiale duhet të jetë e vjetër së paku nga koha e mesme. Gjatë luftës së Dytë Botërore ishte pjesë e zonës së okupuar nga Bullgaria, ndërsa në nëntor të vitit 1944 pushtohet nga Jugosllavia komuniste. Në pikëpamje administrative Vitia me 1912 ishte shpallur komunë.

Komuna e Vitisë shtrihet në pjesën Juglindore të Kosovës, rajoni i Anamoravës, përafërsisht 40 km në jug të Prishtinës. Kufizohet me pesë (5) komuna tjera (Gjilanin, Ferizajn, Kaçanikun Kllokotin e Parteshin dhe në jug me Republikën e Maqedonisë. Pozita gjeografike që ka i mundëson asaj lidhje të mira me qendrat tjera të Kosovës dhe të rajonit. Lumi "Morava" e Binçës kalon përmes luginës qendrore të komunës, ku krijon kushte më të favorshme për aktivitete bujqësore. Vitia i takon zonës me klimë të mesme kontinentale, ku lartësia mbidetare nuk i kalon mbi 1400 metra.

Komuna e Vitisë ka gjithsej 39 vendbanime. Prej tyre janë 38 fshatra dhe qyteti i Vitisë. Sipas rezultateve preliminare të regjistrimit të popullsisë të vitit 2011, Komuna e Vitisë ka 46951 banorë rezidentë dhe 13604 banorë jashtë Kosovës, të organizuar në 7519 ekonomi familjare. Pra 69% nga popullsia del se janë mbi moshën 15 vjeçare. Nga viti 2011 deri ne vitin 2019 popullsia e Komunës së Vitisë ka tendenca të rritjes. Sipas përkatësisë gjinore, përbërja meshkuj femra është 49.60% femra dhe 50.40% meshkuj. Në raport të popullsisë qendër dhe pjesëve rurale, përqindja e popullsisë që jetojnë në qytet sillet rreth 10% dhe 90% në pjesët rurale (fshatra).

Sipas përbërjes etnike, popullsia në Komunën e Vitisë ka këtë statistikë: gjithsej janë 99.3% janë shqiptar, ndërsa minoritetet tjera janë serb me 113 serb, 25 boshnjak, 14 ashkali, 12 rom, 7 goran, 4 turq dhe të tjerë janë 143 banor, që në përqindje i bie 0.7 % minoritete tjera jo shqiptare. Sa i përket natalitetit dhe mortalitetit, gjatë vitit 2019 numri i lindjeve (nataliteti) është 696 lindje dhe 254 vdekje (mortaliteti).

Migrimi i popullsisë vitiase është përshkruar me trend të rritjes si nga brenda ashtu edhe nga jashtë shtetit. Sot konsiderohet se përqindja e migrimit të jashtëm të popullsisë është 13180 banorë apo 28% e numrit të përgjithshëm të banorëve, që jetojnë, veprojnë e punojnë jashtë Kosovës, ndërsa migrimi i brendshëm është i theksuar.

Sa i përket moshës së popullsisë, kryesisht dominon mosha 0 - 19 vjeç, apo në përqindje 41.10%; mosha 20 - 64 vjet, apo 52.50%; dhe mosha mbi 65 vjeç, 6.40%.

Në aspektin gjeografik Vitia është e vendosur në rrugën rajonale që lidhë Gjilanin dhe Ferizajn, ndërsa lumi "Morava" kalon nëpër komunë, duke krijuar kushte të mira për bujqësi.




*Fig.1. Pozita gjeografike e komunës së Vitisë në hartën e Republikës së Kosovës*

## Buxheti Komunal

## Shpërndarja e Buxhetit sipas linjave dhe granteve buxhetore

KUFIJT BUXHETOR SIPAS GRANTEVE PËR VITET 2023-2025

| Përshkrimet | Viti 2023 | Viti 2024 | Viti 2025 |
|---|---|---|---|
| Të hyrat nga tatimi në pronë | 650,205 | 670,917 | 694,434 |
| Granti i përgjithshëm | 6.395.380 | 6,855.583 | 7.305.764 |
| Granti i arsimit | 5.126.454 | 5.862.379 | 5,882,783 |
| Granti i shëndetësisë | 1.861.704 | 1.954.789 | 2.052.529 |
| Granti për shërbimet rezidenciale | **160.000** | **185.000** | **185.000** |
| Te hyrat vetanake | 402.614 | 422.744 | 443.881 |
| **Totali** | **14.996.357** | **15.954.412** | **16.564.391** |

## Krahasimi i kufijve Buxhetor për vitet 2020/2021/2022

KUFIJT BUXHETOR SIPAS GRANTEVE PËR VITET 2020-2022

| Përshkrimet | Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2022 |
|---|---|---|---|
| Të hyrat nga tatimi në pronë | 430,000 | 439,589 | 592,320 |
| Granti i përgjithëshëm | 4.919.201 | 4,575,868 | 4.850.186 |
| Granti i arsimit | 4.855.987 | 5.425.184 | 5,603,057 |
| Granti i shëndetësisë | 1.581.704 | 1.628.384 | 1.628.384 |
| Totali i transfereve qeveritare | **11,354,892** | **12,629,436** | **12,081,627** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Te hyrat vetanake | 518.599 | 421,661 | 395,548 |
| **Totali i Të hyrave vetanake** | **948.599** | **861,250** | **987,868** |

# KAPITULLI I

## GJENDJA AKTUALE

## SEKTORI PRIVAT

Komuna e Vitisë para dhe pas Luftës së fundit të vitit 1999, përveç se njihej për zhvillimin e bujqësisë, angazhimi i popullsisë në veprimtari primare ekonomike vazhdon të jetë i lartë, edhe pse kohëve të fundit ka një rritje të angazhimit në sektorë të tjerë ekonomik, siç janë: tregtia, prodhimi, ndërtimtaria dhe industria. Ajo që mund të theksohet në këtë rast është se, shkalla më e ulët e aktivitetit ekonomik është tek gjinia femërore edhe pse viteve të fundit kemi rritje të konsiderueshme. Komuna e Vitisë është në fazën e ndërtimit të Zonës Ekonomike Komunale, e cila do të shërbej për zhvillimin ekonomik komunal të Vitisë me rrethinë, si dhe hapjen e vendeve të punës.

**Klasifikimi i ndërmarrjeve të regjistruara sipas pronësisë**

Sa i përket klasifikimit të ndërmarrjeve të regjistruara sipas pronësisë, 1167 ndërmarrje (97.5 % e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të regjistruara) janë private, 14 ndërmarrje (1.2 % e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të regjistruara) janë publike-komunale, 9 ndërmarrje (0.8 % e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të regjistruara) janë publike-shoqërore dhe 7 ndërmarrje (0.6 % e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të regjistruara) janë publiko – private.

Sa i përket numrit të të punësuarve, 79.1 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve punojnë në sektorin privat, 12.5 % e tyre punojnë në ndërmarrje publike-shoqërore, 8.4 % punojnë në ndërmarrje publiko – private.

Më poshtë, klasifikimi i ndërmarrjeve të regjistruara sipas pronës në Komunën e Vitisë është krahasuar me gjendjen në komunat e Istogut dhe Skenderajt.

| *Nr.* | *Komuna* | *Viti* | *Istog* | *Skenderaj* |
|---|---|---|---|---|
| | | *%* | *%* | *%* |
| *1.* | *Private* | *97.5%* | *91.5%* | |
| *2.* | *Publike (Komunale)* | *1.2* | | |
| *3.* | *Publike (Shoqërore)* | *0.8* | | |
| *4.* | *Publiko - private* | *0.6* | | |

*Tabela 1. Krahasimi klasifikimi të ndërmarrjeve të regjistruara në komunat tjera*

Klasifikimi i sektorëve ekonomik sipas numrit të ndërmarrjeve të regjistruara dhe numrit të të punësuarve. Nga të gjithë sektorët ekonomik në Komunën e Vitisë, sa i përket numrit të ndërmarrjeve të regjistruara, aktivitetet shërbyese zënë vendin e parë, me 58.2 % të numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve të regjistruara dhe 22.89 % e numrit të përgjithshëm të punëtorëve të regjistruar. Ndërtimtaria zë vendin e dytë, me 12.3 % të ndërmarrjeve të regjistruara dhe 11.61 % të punëtorëve të regjistruar, ndërsa vendin e tretë e zë tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave, me 9.9 % të ndërmarrjeve të regjistruara dhe 30.75 % të

punëtorëve të regjistruar. Në pozitën e tetë dhe të fundit sa i përket numrit të ndërmarrjeve të regjistruara radhitet sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim, me vetëm 0.3 % të numrit të ndërmarrjeve të regjistruara dhe vetëm 0.9 % të numrit të përgjithshëm të të punësuarve.

| **Nr.** | **Sektori** | **Nr. i Ndërmarrjeve** | **% e Totalit të Ndërmarrjeve** | **Nr. i të punësuarve** | **% e Totalit të të punësuarve** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Aktivitete Shërbyese | **697** | **58.2** | 885 | 22.89 |
| 2 | Ndërtimtaria | **147** | **12.3** | 449 | 11.61 |
| 3 | Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave | **119** | **9.9** | 1189 | 30.75 |
| 4 | Industria Përpunuese | **112** | **9.4** | 942 | 24.36 |
| 5 | Transporti dhe Magazinimi | **52** | **4.3** | 71 | 1.83 |
| 6 | Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit | **50** | **4.2** | 91 | 2.35 |
| 7 | Furnizimi me ujë; kanalizimi, menaxhimi me mbeturina dhe aktivitetet rehabilituese | **8** | **0.7** | 157 | 4.06 |
| 8 | Xeheroret dhe gurëthyesit | **8** | **0.7** | 66 | 1.70 |
| 9 | Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim | **4** | **0.3** | 16 | 0.41 |
| **TOTA** | | **1197** | **100** | **3866** | 100 |

***Tabela 2. Renditja e Sektorëve Ekonomik sipas numrit të ndërmarrjeve të regjistruara (ARBK)***

Bazuar në klasifikimin e sektorëve sipas numrit të ndërmarrjeve të regjistruara dhe numrit të të punësuarve, dominojnë: aktivitet shërbyese, ndërtimtaria dhe tregtia me shumicë dhe pakicë, ndërsa në vendin e fundit në këtë klasifikim renditet sektori i furnizimit me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër për kondicionim.

Klasifikimi i sektorëve ekonomik sipas përqindjes së ndërmarrjeve të regjistruara në Komunën e Vitisë krahasuar me Komunën e Istogut dhe Skenderajt:

| Nr. | Komuna | Viti | Istog | Skenderaj |
|---|---|---|---|---|
| | Sektori | % e totalit të ndërmarrjeve | % e totalit të ndërmarrjeve | % e totalit të ndërmarrjeve |
| 1 | Aktivitete shërbyese | 58.2 | 13.40 | 47.0 |
| 2 | Ndërtimtaria | 12.3 | 6.26 | 12.7 |
| 3 | Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve | 9.9 | 17.93 | 7.2 |
| 4 | Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit | 4.2 | 9.33 | 4.8 |
| 5 | Të tjera | | | 28.3 |
| | Totali | 100 | 100 | 100 |

*Tabela 3. Klasifikimi i sektorëve ekonomik sipas përqindjes së ndërmarrjeve të regjistruara në Komunën e Vitisë krahasuar me Komunën e Istogut dhe Skenderajt*

Sa i përket shpërndarjes së bizneseve sipas vendbanimeve, në kontekst të raportit vendbanim urban dhe periferik, 77.2 % e ndërmarrjeve janë të vendosura, ose veprimtarinë primare e zhvillojnë në zona periferike (jashtë zonës urbane), ndërsa vetëm 22.8 % e tyre janë të vendosura ose veprimtarinë primare e zhvillojnë në zonën urbane, ndërsa sa i përket numrit të të punësuarve nëpër ndërmarrjet e shpërndara sipas vendbanimeve: 2405 punëtorë (62.20 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve punojnë në ndërmarrjet e vendosura në zona periferike, përderisa 1461 punëtorë (37.79 % e numrit të përgjithshëm të të punësuarve punojnë në ndërmarrjet e vendosura në zonën urbane).

| Nr. | Lloji i Vendbanimit | Nr. i ndërmarrjeve | % e Totalit të Ndërmarrjeve | Nr. i të punësuarve | % e Totalit të të punësuarve |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Vendbanimi B (Zonat Periferike) | 924 | 77.2 | 2405 | 62.20 |
| 2 | Vendbanimi A (Zona Urbane) | 273 | 22.8 | 1461 | 37.79 |
| **TOTALI** | **1197** | **1197** | 100 | **3866** | **100** |

***Tabela 4. Renditja e vendbanimeve (urbane dhe rurale) sipas numrit të bizneseve të regjistruara (ARBK).***

## *Veprimtaritë punuese, bizneset, punësimi dhe qarkullimi.*

Nga viti 2018-2019 vlera e qarkullimit ka pas një rritje mesatare vjetore për 21.4%, kurse rritja e përgjithshme ka shënuar 33.2% e bizneseve të Komunës së Vitisë. Vlen të theksohet se, sektori i tregtisë me shumicë dhe pakicë mbetët sektori më i madh sa i përket vlerave të qarkullimit me 53% dhe industria përpunuese me 32%.

| Veprimtaria | Nr. i bizneseve | Punësimi | Qarkullimi |
|---|---|---|---|
| Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave | 119 | 1189 | 53% |
| Industria përpunuese | 112 | 942 | 32% |
| Ndërtimtaria | 147 | 449 | 2% |
| Aktivitetet shërbyese | 697 | 885 | 1% |

***Tabela 5. Veprimtaritë punuese, bizneset, punësimi dhe qarkullimi.***

## Shtrirja gjeografike e ndërmarrjeve ekonomike në Komunën e Vitisë

Sa i përket shtrirjes gjeografike të ndërmarrjeve ekonomike në Komunën e Vitisë, 22.8 % e ndërmarrjeve të regjistruara veprimtarinë e tyre ekonomike e zhvillojnë në qytetin e Vitisë (zona urbane), ndërsa në vendin e dytë me përqindjen më të madhe të koncentrimit të bizneseve gjendet Pozharani me 14.5% të ndërmarrjeve të regjistruara. Vendbanimet në të cilat pjesëmarrja e bizneseve është më e ulët se 1 % janë si vijon: Binça, Tërsteniku, Letnica, Devaja, Podgorci, Godeni i Madh dhe Çiflaku. Këto fshatra kanë një përqindje e cila varion nga 0.5 deri në 0.1, ndërsa vendbanimet të cilat nuk kanë asnjë ndërmarrje ekonomike të regjistruara, e numri i të cilave është vetëm 5, janë si vijon: Mjak, Stubëll e Poshtme, Shashare, Vërnakollë dhe Vërnez.

## Shërbimet

Me 697 ndërmarrje të regjistruara dhe me 885 punëtorë të punësuar, sektori i shërbimeve është sektori më i zhvilluar në Komunën e Vitisë dhe radhitet në pozitën e parë sa i përket numrit të ndërmarrjeve të regjistruara, ndërsa sa i përket numrit të të punësuarve zë vendin e tretë. Vetëm në vitin 2019 në këtë sektor janë regjistruar 67 ndërmarrje të reja, me 82 të punësuar, ndërsa deri në Gusht të vitit 2020 në këtë sektor janë regjistruar 43 ndërmarrje të reja me 53 të punësuar. Duke u bazuar në trendët regjionale, kombëtare por edhe ato globale, sektori i shërbimeve pritet të rritet në vazhdimësi, andaj edhe në Komunën e Vitisë pritet që ky sektor të shënoj rritje të vazhdueshme, edhe për sa i përket themelimit/hapjes së bizneseve të reja, por edhe krijimit të vendeve të reja të punës.

## Tregtia

Në Komunën e Vitisë kemi të regjistruara 1.197 ndërmarrje në total, prej të cilave 1167 vijnë nga sektori privat. Nga të gjitha ndërmarrjet e regjistruara, 119 apo 9.9% e totalit të ndërmarrjeve të regjistruara i takojnë sektorit të tregtisë. Duke u bazuar në këto të dhëna, konstatohet se tregtia është sektori i tretë më i rëndësishëm ekonomik në Komunën e Vitisë, ndërsa sa i përket numrit të të punësuarve, me gjithsej 1189, tregtia është sektori i parë më i madh në Komunën e Vitisë. Në Komunën e Vitisë kemi dy tregje: tregun e gjelbër dhe tregun e kafshëve, do të vazhdoj organizimi i tregjeve te hapura në Viti dhe Pozheran, duke zgjeruar tregjet edhe në disa vendbanime të mëdha me infrastrukturë të mbuluar, si dhe themelimi së paku i një tregu të gjelbër ditor publik ose privat. Këto tregje administrohen nga ndërmarrja "Ekohigjena", Ne komunë, institucionet, organizatat

dhe shoqatat që stimulojnë aktivitetin tregtar në Komunën e Vitisë janë shoqata e afaristëve, shoqata e ekonomistëve, shoqata e blegtorëve etj.

## Industria

Gjendja ekzistuese e industrisë në Komunën e Vitisë është zhvillim e sipër. Pjesërisht punon N.P. "VINEX" për përpunimin e metalit. Në industrinë e drurit operon fabrika për terjen e drurit në fshatin Drobesh, kurse në industrinë e tekstilit operon N.P. ,"Stubllateks", e cila merret me qepjen e rrobave, etj. Nga gurthyesit operojnë dy kompani dhe disa ndërmarrje të tjera punuese që merren me bluarjen e gurit. Kompanitë private e veçanërisht ato të prodhimit që ndikojnë në ngritje të ekonomisë mund të dallohen: Kompania e rrjetit të armaturës "Besa F" në Drobesh, "Rreze Gëzimi" në Pozheran, N.P. "Beti Commerc", kompania për prodhim të elementeve të ujit prej mesingu, N.P. "Metaliku S"", ajo e përpunimit të llamarinës dhe dy kompanitë për prodhimin e materialeve termoizoluese "Dakaterm" dhe "Eurofisi" si dhe disa ndërmarrje të tjera të vogla që merren me përpunimin e drurit, të llamarinës etj. Nga të gjitha ndërmarrjet e regjistruara, 112 ndërmarrje (10.68% e totalit të ndërmarrjeve të regjistruara) i takojnë sektorit të industrisë. Prej tyre 104 ndërmarrje, apo 8,68 % e totalit të ndërmarrjeve të regjistruara i takojnë industrisë përpunuese, ndërsa 8 ndërmarrje apo 0.66 % e totalit të ndërmarrjeve të regjistruara i takojnë sektorit të xeherorëve dhe gurëthyesve, ndërsa sa i përket numrit të të punësuarve, industria në Komunën e Vitisë gjeneron 942 vende pune në total. Prej këtyre të punësuarve 876 punojnë në industrinë përpunuese, ndërsa 66 punojnë në sektorin e xeheroreve dhe gurëthyesve. Për të gjeneruar zhvillim më të madh ekonomik dhe për të rritur numrin e punësimit, Komuna e Vitisë në Planin Zhvillimor Komunal 2010-2020 ka paraparë krijimin e këtyre Zonave Industriale: Zona Ekonomike me statusin Parku Industrial; Zona nr 1: Rruga Terpezë –Zhiti; Zona nr 2: Rruga Zhiti – Devajë; Zona nr 3: Rruga Devaj Radivojcë; Zona nr 4: Rruga Ramjan - Sllakovc deri në piken ku përfundon zona katastrale e Ramjanit & Fshatit Ri; Zona nr 5: Në fshatrat Vernezë, Letnicë dhe Vernakollë. Zona nr.4 është planifikuar për zhvillim kryesisht të blegtorisë dhe industrisë së përpunimit dhe finalizimit të produkteve nga blegtoria, ndërsa duke u bazuar në parimin që objektet industriale të vendosen në hapësirat ku toka është e bonitetit të dobët për zhvilimin dhe kultivimin e kulturave bujqësore, Zonat nr.1, nr. 2, dhe nr.3 janë planifikuar si zona për zhvillimin e aktiviteteve industriale. Për më tepër, këto zona (hapësira) nuk posedojnë pasuri nëntokësore. Këto tri zona mund të shfrytëzohen për aktivitete industriale duke investuar në infrastrukturë rrugore në rrugën nga Fshati ri – Terpezë – Zhiti – Devajë - Budrikë si dhe në atë Devajë – Radivojcë. Përveç infrastruktës rrugore, në PZHK 2010-2020 është paraparë edhe sigurimi i infrastrukturs tjetër përcjellëse për këto zona.





Zona Ekonomike Komunale

## Zejtaria

Zejtaria vazhdon të mbetet një fushë e rëndësishme për zhvillimin ekonomik në Komunën e Vitisë. Ekzistimi i një përvoje të konsiderueshme në veprimtaritë zejtare, qoftë në zejtarinë prodhuese, shërbyese, artistike dhe të artizanateve, konsiderohet përparësi për zhvillimin ekonomik. Zejtaritë ekzistuese prodhuese janë të fokusuara në përpunimin dhe prodhimin e produkteve për treg, kryesisht në seri të vogla e që nuk kanë veçori të prodhimit industrial (instrumente muzikore, vegla për bujqësi etj). Në Komunën e Vitisë janë të njohur edhe zejtarët që merren me zejtari shërbyese në kuptimin e mirëmbajtjeve dhe riparimin e prodhimeve, stabilimenteve, objekteve si dhe kryerjen e shërbimeve të tjera.

## Turizmi

Edhe përkundër mundësive të mjaftueshme dhe potencialit zhvillimor, në Komunën e Vitisë turizmi nuk është i zhvilluar. Deri para ndarjes së Komunës së Kllokotit, në Viti është zhvilluar turizmi shëndetësor, me Banjën e Kllokotit, e cila edhe sot vizitohet nga mijëra vizitorë në baza mujore. Karakteri multietnik, multifetar e multikulturor i popullsisë së Vitisë ka reflektuar edhe në shumësinë e festave fetare (trashëgimi jomateriale) edhe në diversitetin arkitekturor e rrjedhimisht në diversitetin e trashëgimisë arkitekturore. Në ditët e sotme, turizmi kulturor është i bazuar kryesisht në vizitat e objekteve të trashëgimisë arkitekturore si dhe në numrin e madh të vizitorëve gjatë festave të ndryshme fetare. komuna e Vitisë ka potencial të mirë për zhvillim edhe të turizmit natyror e dimëror, por edhe të atij rural dhe kulturor, ndërsa Plani Zhvillimor Komunal aktual i Komunës së Vitisë ka propozuar disa hapa për zhvillimin e këtyre llojeve të turizmit, përfshirë:




*Fig. 2 Harta e pikave turistike ne Komunën e Vitisë*

**Turizmi natyror:** Vikendzona në Debellde, Letnicë, te Shushtë dhe mbi Kabash. (aktivitetet: shtigje të ecjes dhe shëtitje, vrapime dhe çiklizmi malor, kalërim).

Zona malore e komunës shquhet me potenciale të mëdha që do të trajtohen në mënyrë adekuate për zhvillimin e turizmit të bazuar në natyrë. Në këto zona parashikohet të zhvillohet infrastruktura dhe përmbajtjet për sporte malore, si: shtigje të ecjes dhe shëtitje, vrapime dhe çiklizmi malor, kalërim. Këto aktivitete të rekreacionit planifikohen së bashku me shërbimet e akomodimit privat nëpër fshatra, duke ofruar me qera shtëpitë në fermat të cilat mund të sjellin të ardhura shtesë për fermerët dhe planifikohen disa vekend zona në Debellde, Letnicë, te Shushtë dhe mbi Kabash.



**Parku i pishave në Terpezë**

**Turizmi rinor dhe kongresian:** Flakadani i Karadakut, Dita e Zojave, Ditët e Dom Mikelit.
**Turizmi kulturor:** Vitia ka 4 kala (Tërpezë, Binçë, Mjak dhe Lubishtë)

Monumentet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore paraqesin pikat e atraksioneve turistike. (Resurset të pasura natyrore: uji, uji termal dhe termo mineral, pyjet, biodiverziteti). Trashëgimi kulturore: Stublla, Letnica, Tërpeza, Pozharani etj.



Shkolla e pare shqipe "Dom Mikel Tarabulluzi" – Stubell



Shkolla e vjetër shqipe - Pozheran

**Trashëgimi arkeologjike:** Lokaliteti Tuma Ilire Sadovinë, Smirë, Gërmovë, Letnicë, Stubëllë, Urbani (hapësirat, Pozharanë, Tërpezë, Qifllak) etj.
**Trashëgimi arkitekturale:** Letnicë, Binqë, Skifteraj, Stublla.

**Trashëgimi shpirtërore**: Shumë e pasur në Komunën e Vitisë, duke përfshirë format e shprehjes kulturore të traditave ose të zakoneve popullore, të gjuhës, festive, riteve, valles, muzikës, këngës dhe shprehjes artistike.



Muzeu Viti



Manifestim kulturor

**Trashëgimia e pasur natyrore:** (Pejsazhe, monumente të natyrës, trungje të vjetra, monumente gjeomorfologjike etj). Ekzistimi i disa zonave të veçanta (në Sllatinë të epërme gjendet një hapësirë mbi 10h me druj të vjetër me qindra vjet, që në popullatë njihet si vendi i quajtur Mllakë). Kapacitetet për turizëm rinor dhe kongresial, futja e Letnicës në kalendarin e shtegtimeve botërore për Nënë Terezën. Disa ditë që janë të nivelit kombëtar e ndërkombëtar që shënohen në Viti, resurset njerëzore vetëm sa e zgjerojnë ofertën turistike. Prandaj, në të ardhmen duet parashihet rrjeti i pikave artistike të lidhura mirë në mes veti).

**Turizmi rinor dhe kongresial:** Parashihet në qytetin e Vitisë dhe Pozheranit.

**Turizmi shëndetësorë:** Ajri i pastër, mjedisi i qetë dhe pejsazhet e bukura në malet e Letncës, Debëlldeut, pishat në Tërpezë si dhe uji termalë dhe termomineral në Radivojc. Projekti i spitalit në Stubëll janë të përshtatshme për zhvillimin e turizmit shëndetësorë. Në këto zona mund të ndërtohet një qendër rehabilituese për sëmundjet e mushkërive.

**Turizmi rural:** Turizmi rural është i lidhur me zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Në zonat e lartë përmendura keni edhe fermerë të zhvilluar të cilët mund të ofrojnë shërbime të akomodimit duke dhënë me qira dhoma ose shtëpi të vogla për ata që dëshirojnë të shfrytëzojnë shërbimet cilësore të bujqësisë, blegtorisë, natyrës dhe gjahut.



# BUJQËSIA

## Bujqësia me degët e saj

Pozita gjeografike, toka pjellore, kushtet klimatike dhe resurset natyrore e favorizojnë zhvillimin e bujqësisë dhe veprimtarive tjera primare, degë të cilat tradicionalisht kanë pasur rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të Komunës së Vitisë. Komuna e Vitisë ka një sipërfaqe prej 26,969 hektarë tokë, prej së cilës 11,141 hektarë (41.3 % e sipërfaqes totale) është tokë bujqësore. Vetëm në zonën urbane ka 706 ha tokë bujqësore, ndërsa vendbanimet tjera që posedojnë më së shumti tokë bujqësore janë si vijon: Sllatina me 901 Ha, Pozherani me 853 Ha, Zhitia me 703 Ha, Sadovina e Çerkezve me 629 Ha, Gërmova me 522 Ha, Ramjani me 507 Ha etj.. Edhe pse bujqësia ka qenë gjithmonë degë e rëndësishme e ekonomisë për Komunën e Vitisë, vërehet një rënie e interesimit për tu angazhuar në këtë veprimtari, përkundër kushteve të favorshme natyrore dhe traditës. Të dhënat e regjistrimit të vitit 2011 konstatojnë se numri i personave të angazhuar në bujqësi dhe degët e saj është 760, ndërsa sipas të dhënave nga Drejtoria Komunale për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, në sektorin e bujqësisë në mënyrë aktive ushtrojnë aktivitetin e tyre të paktën 1875 ferma, si ekonomi familjare. Kjo shifër është nxjerrë nga numri i fermerëve të Komunës së Vitisë të cilët kanë aplikuar për subvencione dhe grante gjatë vitit 2020.

Në Komunën e Vitisë sipërfaqja e tokës punuese për kokë banori llogaritet të jetë diku rreth 0.23 hektar, kurse madhësia e tokës punuese për familje në mesatare është rreth 1.1 ha. Sa i përket prodhimtarisë bujqësore, toka në mbjelljet vjeshtore mbillet kryesisht me grurë, përderisa në mbjelljet pranverore mbillet me misër dhe bimë foragjere për blegtori. Kulturat tjera të rëndësishme janë perimet, patatet, shalqiri etj. Shumica e prodhuesve janë ekonomi bujqësore familjare dhe vetëm 76 prodhues janë të organizuar në ndërmarrje bujqësore. Pas luftës është vërejtur dukuria e shpërndarjes së pakontrolluar urbane, e cila e degradon tokën bujqësore, ky

fenomen Komunës së Vitisë i ka kushtuar me humbjen e 8.6 ha tokë bujqësore vetëm në 6 vitet e fundit (2015-2020).

**Prodhimtaria Bujqësore (Lavërtaria, Perimkultura dhe Pemëtaria)**

Nga e gjithë sipërfaqja bujqësore e planifikuar për mbjellje për vitin 2020 (9.266 ha), prej prodhimtarisë bimore të kultivuar dominojnë prodhimet e grurit me 4,850 ha dhe misrit me 3,255 ha. Pas tyre vijnë perimet me 719 ha, patatet me 110 ha, misëri i gjelbër me 105 ha etj.

Numri i fermerëve të cilët merren me kultivimin e perimeve në serra me sipërfaqe prej 0.20 ha e më tepër është 15, ndërsa sipërfaqja totale e serrave është 4.76 ha. Llojet e perimeve të cilat kultivohen në serra janë: spec, domate, tranguj, sallatë e gjelbër dhe qepë të njoma, ndërsa kur jemi tek pemëtaria; relievi i rrafshët në disa pjesë të Komunës së Vitisë është shumë i përshtatshëm për kultivimin e pemëve, një veprimtari tradicionale e fermerëve të kësaj ane. Në veçanti me sukses kultivohet kultura e mollës. Bazuar në të dhënat nga Regjistrimi i Bujqësisë për vitin 2020, në Komunën e Vitisë janë rreth 143.69 ha pemishte, kurse 10.81ha pemë të imëta.



**Prodhime Bujqësore vendore (Panairi Bujqësor – Viti )**

| Kultura | Sip. e planifikuar për mbjellje (Ha.) | % e sip. së planifikuar për mbjellje |
|---|---|---|
| **Grurë** | 4850 | 51.48 |
| **Misër** | 3255 | 34.55 |
| **Perime** | 719 | 7.63 |
| **Patate** | 110 | 1.17 |
| **Misër i gjelbër** | 105 | 1.11 |
| **Jonxhë** | 85 | 0.90 |
| **Bari i mbjellë** | 70 | 0.74 |
| **Tërfil** | 30 | 0.32 |
| **Bimë foragjere** | 20 | 0.21 |
| **Thekër** | 8 | 0.08 |
| **Tërshërë** | 7 | 0.07 |

| | | |
|---|---|---|
| **Elb birre** | 4 | 0.04 |
| **Elb pranveror** | 3 | 0.03 |
| **Mollë** | 52.53 | 0.56 |
| **Kumbull** | 18.34 | 0.19 |
| **Dardhë** | 0.31 | 0.003 |
| **Arrë** | 47.35 | 0.50 |
| **Vishnje** | 24.15 | 0.26 |
| **Qershi** | 0.33 | 0.00 |
| **Lajthi** | 0.68 | 0.01 |
| **Dredhëz** | 4.08 | 0.04 |
| **Mjedër** | 6.73 | 0.07 |
| TOTALI | **9420.5** | **100** |

***Tabela 6. Sipërfaqja bujqësore e planifikuar për mbjellje për vitin 2020 dhe kulturat bujqësore***

Sa i përket rendimentit të kulturave bujqësore në Komunën e Vitisë, rendimenti i grurit sillet diku rreth 5000 kg/ha, ai i misrit diku rreth 6500 kg/ha, kurse rendimentet e perimeve sillen diku rreth 35.000 kg/ha. Kur jemi tek vlera financiare e kulturave dhe produkteve bujqësore (e nxjerrë nga llogaritja e rendimentit te pritshëm dhe çmimit për kg në tregun e Kosovës për vitin 2020) totali i vlerës financiare, nga të gjitha kulturat dhe produktet bujqësore të cekura më lartë është 34,259,195 euro.

Sa i përket shpërndarjes hapësinore të fermerëve të regjistruar në Komunën e Vitisë, numri më i madh i tyre vjen nga fshati Gjylekar, me 275 fermerë (15.1 % e totalit) të regjistruar, në vendin e dytë në këtë renditje vjen fshati Pozharan me 155 fermerë (8.5 % e totalit) të regjistruar, i pasuar nga fshati Remnik me 109 (apo 6.0 % e totalit) dhe fshati Smirë me 102 (5.6 % e totalit). Lubishta e cila renditet e pesta në këtë kategorizim, ka 101 fermerë (5.5 % e totalit) të regjistruar. Pas Lubishtes, shpërndarja hapësinore e fermerëve të regjistruar sipas vendbanimeve është si vijon: Tërpeza, Vërbani, Sadovina e Jerlive, Sllatina e Epërme, Vitia (zona urbane), Begunca, Debelldeh etj.. Në 3 pozitat e fundit për sa i përket numrit të fermerëve të regjistruar janë vendbanimet si vijon: Godeni i Madh me 3 fermerë, fshati Shashare me 2 si dhe fshati Vërnez me vetëm 1 fermer të regjistruar.




**Prodhime Bylmeti "Bon Appetit"-Lybishtë**




**"Grasep"- Sllatinë e Epërme**

## Klasifikimi Tokës sipas përshtatshmërisë për prodhimtari bujqësore

Sa i përket klasifikimit të tokës sipas përshtatshmërisë për prodhimtari bujqësore, Komuna e Vitisë ka në disponim këto sipërfaqe:

| **Përshtatshmëria e Tokës Bujqësore** | **Sipërfaqja (Ha)** | **%** |
|---|---|---|
| **Klasa 1** | 5288.7 | 19.6 |
| **Klasa 2** | 4280.3 | 15.9 |
| **Klasa 3** | 4216.0 | 15.6 |
| **Klasa 4** | 1761.3 | 6.5 |
| **Klasa 5** | 4084.4 | 15.1 |
| **Klasa 6** | 6652.7 | 24.6 |
| **Klasa 7** | 476.0 | 1.8 |
| **Klasa 8** | 234.3 | 0.9 |
| **Gjithsej** | **26994** | **100** |

***Tabela 7 Sipërfaqja dhe përqindja e tokës bujqësore sipas klasave të përshtatshmërisë – Bonitetit***

Këto të dhëna tregojnë për një kualitet të lartë të tokës bujqësore në Komunën e Vitisë. Mbi 50% e tokës bujqësore i takon kategorisë I deri IV, që konsiderohet si klasë me bonitet të lartë. Tokat bujqësore e klasit I,II,III dhe IV së bashku përbëjnë 15531.3 ha, apo 57.1 % të të gjithë tokës bujqësore në Komunën e Vitisë. Kategorizimi i tillë i tokave bujqësore është bërë me qëllim të nxjerrës së totalit të tokave që i takojnë klasave 1- 4, e të cilat janë më të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore dhe si të tilla duhet të mbrohen nga ndërtimet eventuale. Nga kjo mund të konstatohet se komuna ka një potencial të lartë për zhvillimin e prodhimtarisë bujqësore.




*Figura 3. Përshtatshmëria e Tokës Bujqësore në Komunën e Vitisë*

## Ujitja e Sipërfaqeve Bujqësore

Sa i përket ujitjes së tokës bujqësore, përkundër projekteve të hartuara, në mënyrë të organizuar është ujitur vetëm një sipërfaqe minimale e tokës. Momentalisht, pjesa më e madhe e tokës e cila ujitet, bëhet nga sektori privat, duke shfrytëzuar puset dhe lumenjtë me pompa të thjeshta me kapacitete të ulëta.

## Sektori i blegtorisë

Zhvillimi i blegtorisë në Viti është në varshmëri nga trendët e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik të vendit. Komuna e Vitisë ka resurse të mira natyrore për zhvillim të blegtorisë, pasi që ka tokë të mirë bujqësore, ku zhvillohen me sukses kulturat bimore, siç janë: drithërat, elbi, tërshëra, thekra, jonxha etj. Së bashku me to edhe potenciali i kullosave si dhe ai i livadheve janë një garancë e mirë për zhvillimin e blegtorisë si dhe paraqesin një bazë të mirë ushqimore për sektorin.

Bazat për hartimin e politikave në këtë sektor janë cekur në Librin e Gjelbër të Ministrisë përkatëse, përmes së cilit synohet zhvillimi i politikës me një qasje të pjesëmarrjes aktive të të gjitha institucioneve relevante, OJQ-ve (gjithsej 13 OJQ aktive në Komunën e Vitisë) që veprojnë në këtë sektor dhe organizatat e fermerëve, përpunuesit dhe tregtarët. Synim kryesor i politikës në aspektin afatshkurtër-mesëm është që të gjeneroj vende të reja pune dhe të ngritë të ardhurat e fermerëve të varfër të ekonomive të vogla bujqësore, të ndihmojnë në zgjerimin e aktiviteteve etj.

Komuna e Vitisë ka një fond blegtoral mjaft të pasur dhe të larmishëm. Ky fond përbëhet kryesisht nga: gjedhët, delet, dhitë, pulat etj.

**Gjedhëtaria:** Paraqet edhe bazën kryesore momentale të zhvillimit të bujqësisë në komunë numëron 2403 krerë lopë qumështi që mbarështohen nëpër ferma komerciale të mëdha, të mesme dhe të vogla, por me tendencë rritjeje. Ky sektor është duke vënë në lëvizje edhe sektorin e drithërave dhe kulturave forragjere nga i cili siguron bazën ushqimore. Në anën tjetër, sektori i qumështit është relativisht i zhvilluar, mirëpo vazhdon të mbetet si potencial ende i pashfrytëzuar mirë në krahasim me resurset të cilat i posedon komuna.

**Lopët qumështore:** Dominon raca simental dhe metisët e saj, Hollshtajn Frizis, Hollshtajn, Red Hollshtajn, Monte Biliard etj, por që nuk dihet saktë numri dhe përqindja e racave të lopëve qumështore. Ky sektor mbështetet nga institucionet qendrore me subvencione direkte si për kokë lope ashtu edhe për litër qumështi sipas kualitetit të këtij të fundit. Mirëpo, fermerët që marrin subvencione sipas kualitetit të qumështit për litër janë të pakët, sepse mungon një vetëdijesim i duhur i fermerëve për të aplikuar praktikat e mira të mbarështimit, higjienës, ushqimit dhe komplet menaxhimit të fermës. Në Komunën e Vitisë ka 83 ferma me nga dhjetë e më tepër krerë, me 1740 krerë lopë qumështore në total, ndërsa numri total i lopëve qumështore në Komunën e Vitisë është 2403 krerë.

**Gjedhet për trashje:** Paraqesin një potencial të mirë të sigurimit të lëndës së parë ushqimore - mishit dhe produkteve tjera nga mishi. Komuna ka resurse të mira falë tokës bujqësore që dominon nga klasat e para dhe të dyta për të siguruar bazë ushqimore në viset e rrafshëta. Në anën tjetër, në pjesën kodrinore malore ka mjaft kullosa dhe livadhe për të mbarështuar gjedhin për mish. Te gjedhi për mish dominojnë metisë të racave të ndryshme; më shumë nga Simentali dhe Busha dhe më pak të racave tjera. Në Komunën e Vitisë ka 2 ferma me nga 30 e më shumë gjedhe për trashje.

**Delet dhe dhitë:** Komuna ka një fond të vogël të dhive dhe të deleve, siç edhe është elaboruar në tabelë. Mirëpo, kapacitetet e resurseve natyrore (livadhet, kullosat, pyjet, arat) mund të absorbojnë një fond deri 6 herë më të madh të dhive dhe 2 herë më të madh të deleve. Përderisa tek dhitë dominojnë racat ballkanike, tek delet dominojnë racat metisët e deles së Sharrit, Virtemberg dhe raca tjera, por që nuk japin sa duhet rendiment qumështi dhe mishi. Në këtë sektorë operojnë gjithsej 62 ferma.

**Pulat Vojse:** Nënsektori i Shpezëve (pula vojse) po ashtu paraqet një potencial të mirë zhvillimor. Në këtë sektorë operojnë gjithsej 5 ferma.

**Brojlerët (zogjtë për mish):** Kjo kategori e shpezëve është fare pak e zhvilluar edhe ate më shumë në ekonomi familjare, por që duhet kushtuar një vëmendje të krijimit të fermave komerciale, sepse ka një treg të mirë konsumi.

**Bletaria:** Përkundër një numri të konsiderueshëm të shoqërive bletësh që ka, ky sektor vlerësohet ende i vogël, por edhe i pashfrytëzuar në raport me potencialin dhe kapacitetet ekzistues, si për nga sasia ashtu edhe për nga rendimenti. Komuna e Vitisë ka resurse të mira për zhvillim të këtij sektori, mirëpo, ashtu sikur sektorëve tjerë blegtoral, edhe sektorit të bletarisë i mungon aplikimi i praktikave të mira për mbarështim. Në këtë sektorë janë 98 fermerë, me mbi 30 koshere secili.

| Lloji / Viti | 2016 | 2017 | 2018 | 2019 | 2020 |
|---|---|---|---|---|---|
| Lopë qumështi | 2451 | 2495 | 2493 | 2142 | 2403 |
| Dele | 10782 | 11720 | 13.719 | 12.937 | 13.518 |
| Dhi | 572 | 800 | 1233 | 1190 | 1042 |
| Dosa | 61 | 181 | 248 | 108 | 199 |
| Pula vojse | 10500 | 12800 | 16500 | 17780 | 15681 |
| Bletë | 2884 | 3359 | 4697 | 6091 | 6861 |

*Tabela 8. Fondi Blegtoral në Komunën e Vitisë për vitet 2016-2020*

# ARSIMI

Struktura organizative e sistemit arsimor në Komunën e Vitisë është e organizuar në katër nivele: arsimin parashkollor (5 - 6 vjeçar), arsimin fillor (I – V), arsimin e mesëm të ulët (VI – IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (X – XII). Numri i objekteve të shkollave fillore të mesme të ultë gjithsej është 34. Kemi edhe 3 objekte shkollore të shkollave të mesme të larta dhe 2 çerdhe. Nga të gjitha shkollat fillore, 17 prej tyre janë amë dhe 17 të tjera janë satelite (paralele të ndara). Në procesin edukativo-arsimor janë të angazhuar gjithsej 780 punëtorë. Prej tyre 670 mësimdhënës, 32 punëtorë administrativ dhe 76 punëtor teknik. Numri i nxënësve gjithsej është 7507, çka do të thotë se kemi 11.20 nxënës për 1 mësimdhënës.

**Çerdhe dhe kopshte:** Komuna e Vitisë posedon 2 çerdhe, si: "Gëzimi Ynë" në Viti dhe paralelja nën moshën pesë vjet me kushte solide në Çifllak. Çerdhja në Viti ka 108 fëmijë, ku janë të angazhuar 8 edukatorë, 2 punëtorë administrativ dhe 5 punëtor teknik. Ka një hapësirë prej 520 $m^2$ dhe oborrin me një hapësirë prej 2800 $m^2$. Sipas këtyre shënimeve del se në këtë çerdhe kemi 5.2 $m^2$ hapësirë shkollore për fëmijë si dhe mesatarisht 12.5 fëmijë për edukatorë. "Gëzimi Ynë" paralele në Çifllak ka 43 fëmijë, 4 edukatorë dhe 1 punëtor teknik.

**Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët (i obliguar): Në tërë territorin e komunës mësimi fillor dhe i** mesëm i ulët zhvillohet në 34 objekte shkollore, mësimet i ndjekin 5928 nxënës. Mesatarisht rreth 2.12 $m^2$ hapësirë e brendshme shkollore i takojnë një nxënësi ne këtë nivel. Me hapësirë shkollore më të vogël për kokë nxënësi na paraqiten shkollat në këto vendbanime: Drobesh (1.58 m2 për nxënës), Smirë (1.8 m2 për nxënës), Ramnisht ( 2.1 për nxënës së shkollës fillore), Viti (2.9 mm2 për nxënës). Raporti nxënës/mësimdhënës në këto hapësira shkollore sillet rreth 12 nxënës mesatarja për 1 mësimdhënës me dallime të theksuara nga njëra shkollë në tjetrën. Arsimi i mesëm i lartë - përfshin tri dhe katër vite të shkollimit për nxënësit e grup-moshës 15 deri 18 vjeç. Në këtë komunë janë tri shkolla të mesme: Gjimnazi "Kuvendi i Lezhës" dhe Shkolla e Mesme Teknike "Januz Zejnullahu" në Viti si dhe shkolla e Mesme "Kongresi i Manastirit" në Pozheran. Në këto shkolla numri i nxënësve që i ndjekin mësimet është 1579 nxënës, me një kuadër të mësimdhënësve prej 160 që janë të angazhuar në procesin edukativo-arsimor. Rreth 5.4 $m^2$ hapësirë e brendshme shkollore i takojnë një nxënësi, ndërsa, raporti nxënës/1mësimdhënës në shkollat e mesme është 11.6 nxënës për 1 mësimdhënës.




SHMP "Jonuz Zejnullahu"



